



*Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment in Albania
for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation*

A project for Albania funded by the European Union

Draft

VKM

**PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT TË MJEDISIT DHE KËRKESAT PËR DISA
NDOTËS NË LIDHJE ME TË¹**

Draft 2

Version 3

7.12.2013

I Ky vendim përafron

- Direktivën 2008/50/EC Mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe një ajër më të pastër në Evropë. Nr. Celex 32008L0050, publikuar në Fletoren Zyrtare L 152, 11.6.2008, dhe
- Direktivën 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, mërkurin, nikelin dhe hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e ambientit. Nr.Celex 32004L0107, publikuar në Fletoren Zyrtare L 023, 26/01/2005



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIMI

Nr. _____, datë _____

**“PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT TË MJEDISIT DHE KËRKESAT PËR
DISA NDOTËS NË LIDHJE ME TË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Ligjit nr. _____, datë _____, “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër”, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është:
 - a. përcaktimi i vlerave kufi, vlerave prag dhe vlerave të synuara për disa ndotës në ajër, si dhe objektivave për cilësi të shëndetshme të ajrit të mjedisit;
 - b. përcaktimi i metodave dhe kritereve për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit;
 - c. promovimi i rritjes së bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm brenda vendit, si dhe me vende të tjera.

II. PËRKUFIZIME

2. Termat e përkufizuar në nenin 3, të Ligjit nr..... datë _____ “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër” kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:
 - a) “Arsenik, kadmium, nikel dhe benzo(a)piren” është përmbajtja totale e këtyre elementëve dhe përbërësve në fraksionin e PM₁₀;
 - b) “Burimet e shpërndarjes” janë një numër i madh i burimeve të papërcaktuara të shpërndara në zonë ose aglomeratë;
 - c) “Burim i palëvizshëm” është objekti që lëshon ndotës nga një pozicion i palëvizshëm;
 - d) “Burim i lëvizshëm” është burimi që lëshon ndotje kur është në lëvizje;
 - e) “Depozitim” është masa e ndotësve e transferuar nga atmosfera në sipërfaqe (p.sh tokë, bimë, ujë, ndërtesa, etj) në një zonë të dhënë brenda një periudhe të dhënë;

- f) "Depozitimi total ose i plotë" është gjithë masa e ndotësve që transferohet nga atmosfera në sipërfaqen e tokës, bimësisë, ujit, ndërtesave, etj. brenda një periudhe kohe të caktuar.
- g) "Detyrimi i përqëndrimit të ekspozimit" është niveli i fiksuar në bazë të treguesit të ekspozimit mesatar me qëllim pakësimin e efekteve të dëmshme në shëndetin publik, që duhet arritur gjatë një periudhe të dhënë;
- h) "Hidrokarburet aromatike policiklike" janë ato përbërje organike që përbëhen të paktën prej dy unazash aromatike të shkrira të formuara plotësisht nga karboni dhe hidrogjeni;
- i) "Kontributi nga burimet natyrore" janë shkarkimet e ndotësve që nuk shkarkohen direkt ose indirekt nga aktivitetet e njeriut, përfshirë dukuritë natyrore si shpërthimet vullkanike, aktivitetet sizmike, aktivitetet gjeotermike, zjarret e egra të tokës, dukuritë e erës së fortë, spërkatjet detare, ri-pezullimi atmosferike ose transporti i lëndës natyrore nga rajonet e thata;
- j) "Matje fikse" janë matjet e kryera në territore të caktuara, në vazhdimësi ose nga marrja e mostrave të rastësishme për të përcaktuar nivelet në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave përkatëse;
- k) "Matjet treguese" janë matjet që plotësojnë objektivat e cilësisë së të dhënave që janë më pak të sakta, se ato që kërkohen për matjet fikse;
- l) "Mërkuri i gaztë total" është avulli elementar i mërkurit (Hg 0) dhe mërkuri reaktiv i gaztë, p.sh. llojet e mërkurit të tretshëm në ujë me trysni avulli mjaftueshmërisht të lartë për të ekzistuar në fazën e gaztë.
- m) "Nivel kritik" është niveli fiks në bazë të njohurive shkencore, mbi të cilin mund të ndodhin efekte negative të drejtpërdrejta tek disa receptorë, të tillë si pemët, bimë të tjera ose eko-sistemet natyrore, por jo tek njerëzit;
- n) "Okside të azotit" është shuma e raportit të përzierë të vëllimit (ppbv) të monoksidit të azotit (oksidi nitrik) dhe dikoksidi i azotit e shprehur në njësi të përqendrimit të masës së dioksidit të azotit ($\mu\text{g}/\text{m}^3$);
- o) "Objektiv afatgjatë" është niveli që duhet arritur në periudhë afatgjatë, të ruhet kur nuk është i arritshëm nëpërmjet masave proporcionale, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të shëndetit publik dhe mjedisit;
- p) "Prag i sipërm i vlerësimit" është niveli nën të cilin kombinimi i matjeve fikse dhe teknikave të modelimit dhe/ose matjet treguese mund të përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit të mjedisit;
- q) "Prag i poshtëm i vlerësimit" është niveli nën të cilin modelimi ose vetëm teknikat e vlerësimit objektiv mund të përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit të mjedisit;
- r) "PM₁₀" është lëndë e ngurtë pezull që kalon nëpërmjet një hyrjeje përzgjedhëse sipas madhësisë siç përcaktohet në metodën referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e PM₁₀, S SH EN 12341:2005, me efikasitet me kufi minimal 50 % në një diametër aerodinamik 10 μm ;
- s) "PM_{2,5}" është lëndë e ngurtë pezull që kalojnë nëpërmjet një hyrjeje përzgjedhëse sipas madhësisë siç përcaktohet në metodën referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e PM_{2,5}, S SH EN 14907:2005, me efikasitet me kufi minimal 50 % në një diametër aerodinamik 2,5 μm ;

- t) “Përbërësit organik të avullueshëm” (VOC) janë përbërësit organikë nga burime antropogjenike dhe biogjenike, përveç metanit, që janë të afta të prodhojnë oksidantë fotokimikë nëpërmjet reaksioneve me oksidet e azotit në prani të dritës së diellit;
- u) “Burim i identifikueshëm” është një burim i vetëm i shkarkimeve të ndotësit në ajër, i dallueshëm/ i vecuëshëm nga të tjerët;
- v) Pika për marrje mostrash
- w) “Synimi për pakësimin e ekspozimit kombëtar” është pakësimi i përqindjes së ekspozimit mesatar të popullsisë së Republikës së Shqipërisë i përcaktuar për vitin referencë me qëllim pakësimin e efekteve të dëmshme në shëndetin publik, që duhet arritur, kur është e mundur, gjatë një periudhe të dhënë;
- x) “Substancat pararendëse të ozonit” janë substancat që kontribuojnë në formimin e nivelit bazë të ozonit;
- y) “Tregues i ekspozimit mesatar” është niveli mesatar i përcaktuar në bazë të matjeve në vende me **karakter** urban në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe që reflekton ekspozimin e popullsisë. Ky tregues përdoret për të llogaritur synimin për pakësimin e ekspozimit kombëtar dhe detyrimin e përqendrimit të ekspozimit;
- z) ”Vendndodhje me **karakter** urban” janë vende në zona urbane ku nivelet janë përfaqësuese të ekspozimit të popullsisë në përgjithësi;

III. VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT TË MJEDISIT NË LIDHJE ME DIOKSIDIN E SQUFURIT, DIOKSIDIN E AZOTIT DHE OKSIDET E AZOTIT, LËNDËN E NGURTË PEZULL, PLUMBIN, BENZENIN DHE MONOKSIDIN E KARBONIT

3. Pragjet e vlerësimit

- 3.1 Pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit që zbatohen për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidet e azotit, lëndën e ngurtë pezull (PM₁₀ dhe PM_{2,5}), plumbin, benzenin dhe monoksidin e karbonit brenda një zone ose aglomerati janë të përcaktuara në Seksionin A të Aneksit II të këtij vendimi.
- 3.2 AKM klasifikon zonat dhe aglomeratët sipas kapërcimit ose jo, të pragjeve të sipërme ose të poshtme të vlerësimit referuar në paragrafin 3.1.
- 3.3 AKM rishikon klasifikimin e zonave dhe aglomeratëve referuar në paragrafin 3.2 të paktën çdo pesë vjet dhe më shpesh se pesë vjet, në qoftë se ka ndryshime thelbësore në aktivitetet që mund të ndikojnë në nivelet e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, lëndës së ngurtë pezull (PM₁₀ dhe PM_{2,5}), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit.
- 3.4 AKM rishikon zonat dhe aglomeratët referuar në paragrafin 3.3 në përputhje me procedurat e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit II të këtij vendimi.

4. Kriteret e vlerësimit

- 4.1 AKM vlerëson nivelin e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, lëndës së ngurtë pezull (PM₁₀ dhe PM_{2.5}), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit në të gjitha zonat dhe aglomeratët.
- 4.2 Në të gjitha zonat dhe aglomeratët, ku niveli i ndotësve të referuar në paragrafin 4.1 kapërcen pragun e sipërm të vlerësimit të referuar në paragrafin 3.1, përdoren matjet fikse, por ato mund të plotësohen edhe nga matjet treguese ose modelimi ose nga të dyja së bashku, me qëllim që të sigurohet informacioni i përshtatshëm për shpërndarjen hapësinore të cilësisë së ajrit të mjedisit.
- 4.3 Në të gjitha zonat dhe aglomeratët ku niveli i ndotësve referuar në paragrafin 4.1 është nën pragun e sipërm të vlerësimit por mbi pragun e poshtëm të vlerësimit të referuar në paragrafin 3.1, një kombinim i matjeve fikse dhe modelimit ose matjeve treguese ose të dyjave së bashku mund të përdoren me qëllim që të sigurohet informacioni i përshtatshëm për shpërndarjen hapësinore të cilësisë së ajrit të mjedisit.
- 4.4 Në të gjitha zonat dhe aglomeratët ku niveli i ndotësve të referuar në paragrafin 4.1 është nën pragun e poshtëm të vlerësimit të referuar në paragrafin 3.1, në vend të matjes mund të përdoret modelimi ose teknikat e vlerësimit ose të dyja së bashku.
- 4.5 Kriteret e vlerësimit që përdoren për qëllime të paragrafit 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 janë dhënë në Aneksin III të këtij vendimi.
- 4.6 Përveç vlerësimeve referuar në paragrafet 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4, AKM mat PM_{2.5} në vendet me karakter rural larg nga burimet e rëndësishme të ndotjes së ajrit, me qëllim që të sigurojë informacionin mbi baza mesatare vjetore për përqendrimin total të masës dhe përqendrimet specifike kimike të atij ndotësi.
- 4.7 Gjatë kryerjes së vlerësimit referuar në paragrafin 4.6, AKM përdorë kriteret e mëposhtme:
 - a) Instalimin e të paktën një pike për marrjen e mostrave në vend;
 - b) Ngritjen e të paktën një stacioni matjeje, që mbulon zonat fqinje dhe aglomeratët (ose të barasvlershëm me to) në shtete të tjerë, për arritjen e shpërndarjes së nevojshme hapësinore;
 - c) Koordinimin e monitorimit, kur është e përshtatshme, me strategjinë e monitorimit dhe programin e matjes të Programit të Bashkëpunimit për Monitorim dhe Vlerësimin e Transmetimit në Distançë të Largët të Ndotësve të Ajrit në Evropë.
 - d) Zbatimin e Seksionit A dhe C të Aneksit I të këtij vendimi, në lidhje me objektivat e cilësisë së të dhënave për matjet e përqendrimin të masës së lëndës së ngurtë pezull;
 - e) Zbatimin në tërësi të Aneksit IV të këtij vendimi; dhe

5. Vendodhja dhe numrat e pikave të marrjes së mostrave

- 5.1 AKM instalon pikat e marrjes së mostrave për vlerësimin e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, lëndës së ngurtë pezull (PM₁₀ and PM_{2.5}), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit në vendet e përcaktuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin III, të këtij vendimi.
- 5.2 Në zona dhe aglomeratë ku matja fikse është burimi i vetëm i informacionit për vlerësimin e cilësisë së ajrit, numri i pikave të marrjes së mostrave duhet të jetë më i madh ose i barabartë me numrin minimal të përcaktuar në Seksionin A të Aneksit V të këtij vendimi.
- 5.3 Në zona dhe aglomeratë, përveç atyre të referuar në paragrafin 5.2, numri total i pikave të marrjes së mostrave të përcaktuara në Seksionin A të Aneksit V të këtij vendimi mund të pakësohet deri në 50 %, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:
- a) metodat plotësuese të sigurojnë
 - i. informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e cilësisë së ajrit në lidhje me vlerat kufi ose pragjet e alarmit, si edhe
 - ii. informacionin e përshtatshëm për publikun;
 - b) numri i pikave të marrjes së mostrave që do të instalohen dhe shpërndarja hapësinore e teknikave të tjera:
 - i. të jenë të mjaftueshme për përqendrimin e ndotësit përkatës që do të përcaktohet në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave të përcaktuara në Seksionin A, të Aneksit I të këtij vendimi dhe
 - ii. të mundësojnë përputhshmërinë e rezultateve të vlerësimit me kriteret e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit I të këtij vendimi.
- 5.4 Për qëllime të paragrafit 5.3, rezultatet e modelimit dhe/ose matjes treguese merren parasysh për vlerësimin e cilësisë së ajrit në lidhje me vlerat kufi.

6. Metodatat referencë të matjes

- 6.1 Në varësi të paragrafit 6.2, për qëllime të këtij vendimi përdoren metodatat referencë të matjes dhe kriteret e përcaktuara në Seksionin A dhe C të Aneksit VI të këtij vendimi.
- 6.2 Në varësi të kushteve të përcaktuara në Seksionin B të Aneksit VI të këtij vendimi mund të përdoren metoda të ndryshme nga ato të përcaktuara në paragrafin 6.1.

IV. VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT TË MJEDISIT NË LIDHJE ME OZONIN

7. Kriteret e vlerësimit për ozonin

- 7.1 AKM vlerëson nivelin e ozonit në të gjitha zonat dhe aglomeratët ku përqendrimet e ozonit kanë kapërcyer objektivat afatgjatë të përcaktuara në Seksionin C të Aneksit VII të këtij vendimi gjatë secilit prej pesë vjeçarëve të mëparshëm të matjeve.

7.2 Kur janë të disponueshme të dhëna për më pak se pesë vjet, AKM mund të kombinojë rezultatet nga fushatat e matjeve për kohëzgjatje të shkurtra të kryera, ku dhe kur nivelet e ozonit kanë mundësi të jenë më të lartat me rezultatet e përfuara nga inventarët e shkarkimeve dhe modelimi, me qëllim që të përcaktohet në qoftë se objektivat afatgjatë të referuara në paragrafin 7.1 janë kapërcyer gjatë këtyre pesë vjetëve.

8. Pikat e marrjes së mostrave për ozonin

8.1 AKM instalon pikat për marrjen e mostrave për vlerësimin e ozonit në vendet e përcaktuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin VIII të këtij vendimi.

8.2 Në zona dhe aglomeratë ku matja fikse është burimi i vetëm i informacionit për vlerësimin e cilësisë së ajrit, numri i pikave të marrjes së mostrave për matjet fikse të ozonit nuk duhet të jetë më i vogël se numri minimal i përcaktuar në Seksionin A të Aneksit IX të këtij vendimi.

8.3 Në zona dhe aglomeratë ku informacioni nga matja fikse plotësohet nëpërmjet informacionit të marrë nga modelimi ose matja treguese ose të dyja së bashku, numri i pikave të marrjes së mostrave të referuar në Seksionin A të Aneksit IX, të këtij vendimi mund të pakësohet me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) metodat plotësuese sigurojnë informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e cilësisë së ajrit në lidhje me vlerat e synuara, objektivat afatgjatë, pragjet e informimit dhe të alarmit;

b) numri i pikave të marrjes së mostrave që instalohen dhe shpërndarja hapësinore e teknikave të tjera të jenë të mjaftueshme për përqendrimin e ozonit që do të përcaktohet në përputhje me objektivat e cilësisë së të dhënave të përcaktuara në Seksionin A të Aneksit I të këtij vendimi dhe të mundësojnë përputhshmërinë e rezultateve të vlerësimit me kriteret e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit I të këtij vendimi;

c) numri i pikave të marrjes së mostrave në çdo zonë dhe aglomerat është të paktën një për 2 milionë banorë, ose një për të gjithë territorin e RSH, duke zgjedhur numrin më të madh të pikave që rezultojnë prej tyre. Ky numër nuk duhet të jetë më pak se një pikë në çdo zonë apo aglomerat.

d) dioksidi i azotit matet në të gjitha pikat e mbetura të marrjes së mostrave me përjashtim të stacioneve në vendndodhje me karakter rural të referuara në Seksionin A të Aneksit VIII të këtij vendimi.

8.4 Për qëllime të paragrafit 8.3, rezultatet e modelimit dhe/ose matjes treguese merren parasysh për vlerësimin e cilësisë së ajrit në lidhje me vlerat e synuara.

8.5 AKM siguron që dioksidi i azotit matet në jo më pak se 50% të pikave të marrjes së mostrave të kërkuara nën Seksionin A të Aneksit IX të këtij vendimi.

8.6 Matja e referuar në paragrafin 8.5 duhet të jetë e vazhdueshme me përjashtim të stacioneve në vendndodhje me karakter rural, sic referohet në Seksionin A të Aneksit VIII, ku mund të përdoren metoda të tjera matje.

- 8.7 Në zona dhe aglomeratë ku përqendrimet e ozonit kanë qënë nën objektivat afatgjatë për secilën nga matjet e mëparshme pesë vjeçare, numri i pikave të marrjes së mostrave përcaktohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit IX të këtij vendimi.
- 8.8 AKM siguron që përqendrimet e substancave pararendëse të ozonit të listuara në Aneksin X të këtij vendimi maten të paktën në një pikë të marrjes së mostrave.
- 8.9 AKM mund të zgjedhë vendodhjen dhe numrin e pikave të marrjes së mostrave për matjet e substancave pararendëse të ozonit dhe duhet të marrë parasysh objektivat dhe metodat e përcaktuara në Aneksin X të këtij vendimi.

9. Metodatat referencë të matjes për ozonin

- 9.1 Sipas paragrafit 9.2, për matjen e ozonit zbatohen metodatat referencë të përcaktuara në pikën 8 të Seksionit A të Aneksit VI të këtij vendimi.
- 9.2 Metodatat alternative të atyre të përcaktuara në paragrafin 9.1 mund të përdoren, me kusht që kushtet e përcaktuara në Seksionin B të Aneksit VI të këtij vendimi janë përmbushur.

V. VLERËSIMI I AJRIT TË MJEDISIT NË LIDHJE ME ARSENIKUN, KADMIUMIN, MËRKURIN, BENZO(A)PIRENIN DHE HIDROKARBURE TË TJERA AROMATIKE POLIÇIKLIKE

10. Pragjet e vlerësimit

- 10.1 AKM klasifikon çdo zonë dhe aglomerat në varësi të kapërcimit ose jo të pragut të sipërm dhe të poshtëm të vlerësimit të përcaktuara në Seksionin I të Aneksit XVI të këtij vendimi në lidhje me arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe benzo(a)pirenin.
- 10.2 AKM rishikon klasifikimin e zonave dhe aglomeratëve referuar në paragrafin 10.1 të paktën çdo pesë vjet, dhe më shpesh se çdo pesë vjet në qoftë se ka ndryshime thelbësore në aktivitetet që mund të ndikojnë në nivelet e ndotësve të referuar në paragrafin 10.1 në ajrin e mjedisit.
- 10.3 AKM rishikon zonat dhe aglomeratët referuar në paragrafin 10.2 në përputhje me procedurën e përcaktuara në Seksionin II të Aneksit XVI të këtij vendimi.

11. Kriteret e vlerësimit

- 11.1 AKM vlerëson përqendrimet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në ajrin e mjedisit.
- 11.2 Në zona dhe aglomeratë ku nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit janë mbi pragjet e poshtme të vlerësimit të përcaktuara në Seksionin I të Aneksit XVI të

këtij vendimi, kombinimi i matjeve fikse së bashku me matjet treguese të referuara në Seksionin I të Aneksit XVIII të këtij vendimi ose modelimi, ose të dyja së bashku, mund të përdoren për vlerësimin e nivelit të këtyre ndotësve në ajrin e mjedisit.

11.3 Në zona dhe aglomeratë ku nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit janë nën pragjet e poshtme të vlerësimit të përcaktuar në Seksionin I të Aneksit XVI të këtij vendimi, modelimi ose teknikat e vlerësimit objektiv mund të përdoren në vend të matjes.

11.4 Aty ku ndotësit duhen matur, matjet duhet të bëhen në pika fikse me marrje mostre të vazhdueshme ose të rastit.

11.5 Numri i matjeve duhet të jetë i mjaftueshëm për të lejuar përcaktimin e niveleve.

12. Objektivat për cilësinë e të dhënave

Gjatë vlerësimit të niveleve të arsenikut, kadmiumit, nikelit, benzo(a)pirenit, hidrokarbureve të tjera aromatike policiklike dhe mërkurit të gaztë, AKM zbaton objektivat për cilësinë e të dhënave dhe standarde të tjera të përcaktuara në Aneksin XVIII të këtij vendimi.

13. Vendndodhja dhe numri i pikave të marrjes së mostrave

AKM përcakton vendndodhjen dhe numrin e pikave të marrjes së mostrave për vlerësimin e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në ajrin e mjedisit në përputhje me kriteret e përcaktuara në Aneksin XVII të këtij vendimi.

14. Monitorimi i hidrokarbureve aromatike policiklike

14.1 AKM për vlerësimin e kontributit të benzo(a)pirenit në ajrin e mjedisit, monitoron hidrokarburet aromatike policiklike përkatëse të tjera në një numër të kufizuar territoresh monitorimi.

14.2 Përbërsit e referuar në paragrafin 14.1 përfshijnë minimalisht;

- a) benzo(a)antracenin;*
- b) benzo(b)fluorantenin;*
- c) benzo(j)fluorantenin;*
- d) benzo(k)fluorantenin;*
- e) indeno(1,2,3-cd)pirenin;*
- f) dibenz(a,h)antracenin.*

14.3 Territoret e monitorimit referuar në paragrafin 14.1 vendosen së bashku me territoret e marrjes së mostrave të benzo(a)pirenit.

14.4 Territoret e monitorimit referuar në paragrafin 14.1 përzgjidhen në mënyrë të tillë që variacionet gjeografike dhe tendencat afatgjata të mund të identifikohen në përqendrimet e hidrokarbureve aromatike policiklike.

14.5 Territoret e monitorimit të referuara në paragrafin 14.1 përzgjidhen në përputhje me kriteret e Seksioneve nga I deri në III të Aneksit XVII të këtij vendimi.

15. Monitorimi në sfond

15.1 AKM përdor pika për marrjen e mostrave në sfond për të siguruar matje treguese të:

- a) përqendrimeve të:
 - i. arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit;
 - ii. hidrokarbureve aromatike policiklike të referuara në paragrafin 14.1;
 - iii. mërkurit të gaztë total.

- b) depozitimi total i:
 - i. arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit brenda fraksionit PM₁₀;
 - ii. hidrokarbureve aromatike policiklike të referuara në paragrafin 14.1;
 - iii. mërkurit.

15.2 Për qëllime të paragrafit 15.1 AKM siguron që:

- a) të paktën një pikë për marrjen e mostrave instalohet për të gjithë vendin; dhe
- b) çdo pikë për marrjen e mostrave vendoset në përputhje me Aneksin XVII të këtij vendimi.

15.3 Për vlerësimin e ndikimit rajonal mbi ekosistemet mund të përdoren edhe bio indikatorët.

15.4 Në zonat dhe agglomeratat ku informacioni nga stacionet e matjeve fikse plotësohet me informacion nga burime të tjera (si inventaret e shkarkimeve, metodat e matjeve treguese dhe modelimi i cilësisë së ajrit), numri i stacioneve fikse të matjeve dhe rezolucioni hapësinor i teknikave të tjera janë të mjaftueshme për përcaktimin e përqendrimit të ndotëve në ajër në përputhje me Seksionin I të Aneksit XVII dhe Seksionin I të Aneksit XVIII.

15.5 Sipas rastit monitorimi koordinohet me Strategjinë e Monitorimit dhe Programin e Matjeve për Monitorimin dhe Vlerësimin e Ndotësve (EMEP)

16. Metodat referencë për marrjen e mostrave

Matjet e arsenikut, kadmiumit, mërkurit, nikelit, benzo(a)pirenit, hidrokarbureve të tjera aromatike policiklike në ajrin e mjedisit dhe depozitimi për këta ndotës bëhet në përputhje me metodat referencë të matjes të përcaktuara në Aneksin XIX të këtij vendimi.

VI. DETYRIMET NË LIDHJE ME VLERAT KUFI, VLERAT E SYNUARA, PRAGJET DHE NIVELET

17. Vlerat kufi dhe pragjet e alarmit për mbrojtjen e shëndetit

- 17.1 Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar sipas kompetencave që kanë për fushat që ato mbulojnë, sigurojnë që gjatë zonave dhe aglomeratëve nivelet e:
- dioksidit të squfurit, PM₁₀, plumbit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit nuk kapërcejnë vlerat kufi të përcaktuara në Aneksin XI të këtij vendimi;
 - dioksidit të azotit dhe benzenit në ajrin e mjedisit nuk kapërcejnë vlerat kufi të përcaktuara në Aneksin XI të këtij vendimi nga datat e përcaktuara në atë Aneks.
- 17.2 Përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në pikën a dhe b të paragrafit 17.1 vlerësohet në përputhje me Aneksin III të këtij vendimi.
- 17.3 Për qëllime të pikës a dhe b të paragrafit 17.1 zbatohen marzhet e tolerancës të përcaktuara në Aneksin XI të këtij vendimi.
- 17.4 Pragu i alarmit për përqëndrimet e dioksidit të squfurit dhe dioksidit të azotit në ajrin e mjedisit përcaktohet në Seksionin A të Aneksit XII.
- 17.5 Në zona dhe aglomeratë ku nivelet e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit, PM₁₀, PM_{2,5}, plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit janë nën vlerat përkatëse kufi të përcaktuara në Aneksin XI dhe XIV të këtij vendimi, Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar sipas kompetencave që kanë për fushat që ato mbulojnë, sigurojnë mbajtjen e niveleve të këtyre ndotësve nën vlerat kufi dhe përpiqen të ruajnë cilësinë më të mirë të ajrit të mjedisit, në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm.

18. Vlerat e synuara për arsenikun, kadmiumin, nikelin, merkurin, benzo(a)pirenin dhe hidrokarburet policiklike aromatike

- 18.1 Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeverisjes vendore duke vepruar sipas fushës që ata mbulojnë, marrin të gjitha masat e nevojshme pa shkaktuar kosto jo-proporcionale për të siguruar, që nga [31 Dhjetor 2012] përqëndrimet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit, të përdorur si tregues për riskun kancerogjen të hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e mjedisit, të mos kapërcejnë vlerat e synuara të përcaktuara në Aneksin XV të këtij vendimi.
- 18.2 AKM përgatit listën e zonave dhe aglomeratëve në të cilat nivelet e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit janë nën vlerat e synuara përkatëse.
- 18.3 Ministria, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar sipas kompetencave që kanë për fushat që mbulojnë, sigurojnë ruajtjen e niveleve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në zonat dhe aglomeratët e referuar në paragrafin 18.2, vlerat e synuara përkatëse dhe bëjnë gjithçka/marrin të gjitha masat të ruajnë cilësinë më të mirë të ajrit të mjedisit, në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm.

18.4 AKM harton listën e zonave dhe aglomeratëve në të cilat niveli i arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit është mbi vlerat e synuara përkatëse.

18.5 Për zonat dhe aglomeratët referuar në paragrafin 18.4, AKM përcakton zonat e kapërcimit dhe burimet që kontribuojnë në to. Për zona të tilla Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeverisjes vendore duhet të demonstrojnë zbatimin e të gjitha masave të nevojshme pa kosto jo-proporcionale, drejtuar në veçanti në burimet e shkarkimeve më të mëdha, me qëllim arritjen e vlerave të synuara përkatëse. Për instalimet industriale që kërkojnë leje mjedisi të tipit A në përputhje me Ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” zbatohen Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD).

19. Nivelet kritike për mbrojtjen e bimësisë

19.1 Ministria siguron përputhshmërinë me nivelet kritike për mbrojtjen e bimësisë të përcaktuara Aneksin XIII, sic vlerësohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Seksionin A të Aneksit III.

19.2 Për qëllime të paragrafit 19.1, kur matjet fikse janë burimi i vetëm i informacionit për vlerësimin e cilësisë së ajrit, numri i pikave të marrjes së mostrave nuk duhet të jetë më i vogël se numri minimal i përcaktuar në Seksionin C të Aneksit V të këtij vendimi.

19.3 Për qëllime të paragrafit 19.1, kur matjet fikse plotësohen nga matjet treguese ose modelimi, numri minimal i pikave të marrjes së mostrave mund të pakësohet deri në 50% për aq kohë sa përqëndrimet e vlerësuara të ndotësve përkatës mund të përcaktohen në përputhje me objektivat për cilësinë e të dhënave të përcaktuar në Seksionin A të Aneksit I të këtij vendimi.

20. Objektivat afatgjatë për ozonin

20.1 Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeverisjes vendore duke vepruar sipas kompetencave që kanë për fushat që ato mbulojnë

- a. marrin të gjitha masat e nevojshme pa kosto jo-proporcionale për të siguruar arritjen e vlerave të synuara dhe objektivate afatgjatë për ozonin të përcaktuar në Aneksin VII të këtij vendimi.
- b. për ato zona dhe aglomeratë ku vlera e synuar referuar në paragrafin a është kapërcyer, sigurojnë që programi përkatës për tavanet kombëtare të shkarkimeve dhe në qoftë se është e përshtatshme, plani i menaxhimit të cilësisë së ajrit për arritjen e kësaj vlere të synuar të zbatohet për aq sa kjo vlerë e synuar është e arritshme nëpërmjet masave pa kosto jo-proporcionale duke filluar nga data e përcaktuar në Seksionin B të Aneksit VII.
- c. Për ato zona ose aglomeratë ku nivelet e ozonit në ajrin e mjedisit janë më poshtë ose të barabarta me vlerat e synuara, por më lart se objektivat afatgjatë, përgatisin dhe zbatojnë masa me kosto efektive me qëllim arritjen e këtyre objektivate afatgjatë. Masa të tilla, duhet të paktën, të jenë në harmoni me programin dhe të gjitha planet për cilësinë e ajrit të referuara në paragrafin b.

- d. për ato zona dhe aglomeratë ku nivelet e ozonit arrijnë objektivat afatgjatë marrin masat e nevojshme proporcionale për të:
 - i. mbajtur nivelet nën objektivat afatgjatë, për aq sa e lejojnë faktorët, përfshirë natyrën ndërkufitare të ndotjes së ozonit dhe kushtet meteorologjike, dhe
 - ii. ruajtur cilësinë më të mirë të ajrit të mjedisit në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm dhe nivelin e lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik.

21. Pragjet e informimit dhe të alarmit

21.1AKM, në cdo rast kur kapërcehet pragu i informimit apo ndonjë nga pragjet e alarmit që përcaktohen në Aneksin XII:

- a. ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme për të informuar publikun përmes radios, TV, gazetave apo faqes së vet në internet
- b. Njofton ministrinë për nivelet e regjistruara dhe kohëzgjatjen gjatë së cilës pragu i alarmit apo i informimit është kapërcyer.

22. Kontributet nga burimet natyrore

22.1AKM duhet:

- a. të mbajë për cdo vit listën e zonave dhe aglomeratëve ku kapërcimet e vlerave limit për cdo ndotës, për të cilët zbatohet ky vendim, i atribuohen burimeve natyrore.
- b. të japë në këtë listë:
 - (i) informacionin mbi përqëndrimet dhe burimet e ndotësve të tillë; dhe
 - (ii) evidenca që demonstron se kapërcime të tilla i atribuohen burimeve natyrore.
- c. të publikojë këtë listë së bashku me informacionin referuar në pikën b dhe ta bëjë të disponueshëm për publikun.

22.2Kapërcimi i vlerave limit që i atribuohen burimeve natyrore nuk konsiderohet si kapërcim në kuptimin e këtij Vendimi.

22.3Ministri miraton një udhëzim për demonstrimin dhe zbritjen e masës së kapërcimit që i atribuohet burimeve natyrore.

23. Kapërcimi për shkak të hedhjes së rërës ose kripës në rrugë gjatë dimrit

23.1AKM

- a. mund të përcaktojë zona dhe aglomeratë brenda të cilave vlerat kufi për PM₁₀ në ajrin e mjedisit janë kapërcyer për shkak ri-pezuillimit të lëndës së ngurtë si pasojë e hedhjes së rërës ose kripës nëpër rrugë gjatë dimrit.
- b. mban një listë të zonave dhe aglomeratëve të përcaktuar në përputhje me pikën a, të mësipërme;
- c. jep në listën referuar në pikën b:
 - (i) informacion mbi përqëndrimet dhe burimet e PM₁₀ në të, dhe
 - (ii) provat e nevojshme për të demonstruar që cdo kapërcim është për shkak të ri-pezuillimit të lëndës së ngurtë dhe;
 - (iii) se të gjitha masat e arsyeshme janë marrë për të ulur përqëndrimet.

- d. publikon dhe e bën të disponueshme për publikun listën referuar në pikën b dhe informacionin referuar në pikën c, të këtij paragrafi.
- 23.2 Ministri miraton një udhëzim për përcaktimin e kontributit nga ri-pezuillimi i të lëndës së ngurtë si rezultat i shtrimit të rrugëve me rërë ose kripë gjatë dimrit.

VII. PAKËSIMI I EKSPOZIMIT KOMBËTAR NDAJ $PM_{2,5}$ PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT

24. Tregesi i ekspozimit mesatar ndaj $pm_{2,5}$

24.1 AKM:

- a. llogarit treguesin e ekspozimit mesatar ndaj $PM_{2,5}$ për Republikën e Shqipërisë në përputhje me Seksionin A të Aneksit XIV të këtij vendimi.
- b. siguron, në përputhje me Aneksin III të këtij vendimi, që shpërndarja dhe numri i pikave të marrjes së mostrave në të cilat është mbështetur treguesi i ekspozimit mesatar ndaj $PM_{2,5}$ reflekton ekspozimin e popullsisë së përgjithshme.
- c. siguron që në 1 Janar 2019 numri i pikave të marrjes së mostrave referuar në pikën b nuk duhet të jetë më i vogël se ai i përcaktuar nga zbatimi i Seksionit B të Aneksit V të këtij vendimi.

25. Synimi për pakësimin e ekspozimit kombëtar ndaj $PM_{2,5}$

- 25.1 Synimi për pakësimin e ekspozimit kombëtar për Republikën e Shqipërisë përcaktohet në përputhje me Seksionin B të Aneksit XIV të këtij vendimi.

26. Kufizimi i ekspozimit ndaj $PM_{2,5}$

- 26.1 Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeversijes vendore duke vepruar sipas fushave që ata mbulojnë marrin të gjitha masat e nevojshme dhe pa kosto të tepruara për të siguruar:

- a. arritjen e synimit për pakësimin e ekspozimit kombëtar në 2030.
- b. që përqëndrimi i $PM_{2,5}$ në ajrin e mjedisit nuk kapërcen vlerën e synuar të përcaktuar në Seksionin D të Aneksit XIV të këtij vendimi që nga data e përcaktuar në këtë Seksion.

- 26.2 Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeversijes vendore duke vepruar sipas fushës që ata mbulojnë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që:

- a. treguesi i ekspozimit mesatar ndaj $PM_{2,5}$ për vitin 2025 të mos kapërcejë detyrimin për ekspozimin e përqëndruar të përcaktuar në Seksionin C të Aneksit XIV të këtij vendimi.
- b. Përqëndrimet e $PM_{2,5}$ në ajrin e mjedisit të mos kapërcejnë vlerën kufi të përcaktuar në Seksionin E të Aneksit XIV të këtij vendimi gjatë gjithë zonave dhe aglomeratëve nga data e përcaktuar në këtë seksion.

- 26.3 Ministria vlerëson përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 26.2.b në përputhje me Aneksin III të këtij vendimi.

26.4 Planet e cilësisë së ajrit konsiderojnë marzhet e tolerancës të përcaktuar në Seksionin E të Aneksit XIV të këtij vendimi.

VIII. SHTYRJA E AFATEVE PËR ARRITJEN E VLERAVE KUFI DHE PËRJASHTIMET NGA ZBATIMI I VLERAVE KUFI

27. Shtyrja e disa afateve

27.1 Ministri mund të shtyjë maksimalisht me 5 vjet afatet e përcaktuara në Aneksin XI të këtij vendimi për zonat apo aglomeratet ku vlerat kufi për dioksidin e azotit ose benzenin nuk mund të arrihen brenda këtyre afateve.

27.2 Bashkia/bashkitë përkatëse që mbulojnë zona dhe aglomerate për të cilat afati është shtyrë në përputhje me paragrafin 27.1, përgatit një plan të cilësisë së ajrit për atë zonë ose aglomeratë i cili duhet të plotësohet me informacionin e listuar në Aneksin XX të këtij vendimi, në lidhje me ndotësit përkatës. Ky plan duhet të demonstrojë se si do të arrihen vlerat kufi brenda afatit të ri.

27.3 Kur zbatohet paragrafi 27.1 Ministria, ministritë e linjës sipas rastit dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke vepruar sipas kompetencave që kanë për fushat që ato mbulojnë sigurojnë që vlerat kufi për cdo ndotës nuk është kapërcyer më shumë se maksimumi i kufijve të tolerancës të përcaktuar në Aneksin XI të këtij vendimi për cdo ndotës përkatës.

28. Përfjashtimet nga zbatimi i vlerave kufi

28.1 Zonat ose aglomeratët ku përputhshmëria me vlerat kufi të PM10 të përcaktuara në Aneksin XI të këtij vendimi nuk mund të arrihet për shkak të karakteristikave të vecanta të territorit lidhur me përhapjen në ajër, të kushteve të këqija klimatike apo të kontributeve ndërkufitare, përjashtohen deri në 11 Qershor 2021 nga detyrimi për zbatimin e këtyre vlerave kufi. .

28.2 Kur një vlerë kufi është përjashtuar në përputhje me paragrafin 28.1, bashkia/tët përkatëse përgatit një plan për cilësinë e ajrit për atë zonë ose aglomeratë i cili duhet të plotësohet nga informacioni i listuar në Aneksin XX të këtij vendimi në lidhje me ndotësit përkatës dhe të demonstrojë se si do të arrihen. Plani i cilësisë së ajrit duhet të tregojë që të gjitha masat e përshtatshme janë marrë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar për të arritur këtë afat.

28.3 Kur zbatohet paragrafi 28.1, Ministria, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore sipas kompetencave që kanë për fushat që mbulojnë, sigurojnë që vlerat kufi për cdo ndotës nuk është kapërcyer nga më shumë se maksimumi i kufijve të tolerancës të përcaktuar në Aneksin XI të këtij vendimi për cdo ndotës përkatës.

IX. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

29. Ministria, ministritë e linjës, bashkitë dhe AKM janë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ANEKSI I

Objektivat për cilësinë e të dhënave

(Referuar në paragrafin 4.7.c, 5.3.b, 8.3.b dhe 19.3 të këtij Vendimi)

Seksioni A. Objektivat për cilësinë e të dhënave për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit

	Dioksidi i squfurit, dioksidi i azotit dhe oksidet e azotit, si dhe monoksidi i karbonit	Benzeni	Lëndë e ngurtë pezull (PM ₁₀ /PM _{2.5}) dhe plumb	Ozoni dhe NO dhe NO ₂ përkatës
Matje fikse (1)				
Pasiguria	15%	25%	25%	15%
Sigurimi i të dhënave minimale	90%	90%	90%	90% në verë 75% në dimër
Mbulimi kohor minimal:				
- në zonë urbane dhe trafiku	--	35% (2)	--	--
- në zonat industriale	--	90%	--	--
Matjet treguese				
Pasiguria	25%	30%	50%	30%
Sigurimi i të dhënave minimale	90%	90%	90%	90%
Mbulimi kohor minimal	14% (4)	14% (3)	14% (4)	Më shumë se 10% në verë
Pasiguria e modelimit				
Orare	50%	--	--	50%
Mesatare e tetë orëve	50%	--	--	50%
Mesatare ditore	50%	--	--	--
Mesatare vjetore	30%	50%	50%	--
Pasiguria e vlerësimit të objektivit	75%	100%	100%	75%

Shënime për Tabelën

- (1) AKM mund të zbatojë matje të rastësishme në vend të matjeve të vazhdueshme për benzenin, plumbin dhe lëndën e ngurtë pezull në qoftë se i provon Ministrisë që pasiguria, përfshirë pasigurinë për shkak të marrjes së mostrave të rastësishme, arrin objektivin e cilësisë prej 25 % dhe mbulimi kohor është akoma më i madh se mbulimi kohor minimal për matjet treguese. Marrja e mostrave të rastësishme duhet të shpërndahet njëtrajtësisht gjatë vitit me qëllim që të shmanget shtrembërimi i rezultateve. Pasiguria për shkak të marrjes së rastësishme të mostrave mund të përcaktohet nga procedura e përcaktuar në ISO 11222 (2002) ‘Cilësia e Ajrit — Përcaktimi i Pasigurisë së Kohës Mesatare i Matjeve të Cilësisë së Ajrit’. Në qoftë se për të vlerësuar kërkesat e vlerës kufi PM10 përdoren matjet e rastësishme, në vend të numrit të kapërcimeve, që influencohet shumë nga masa e mbulimit të të dhënave, duhet të vlerësohet niveli në percentile prej 90,4 (të jetë më i vogël se ose i barabartë me 50 µg/m³).
- (2) Të shpërndara gjatë vitit për të qenë përfaqësuese të kushteve të ndryshme që lidhen me klimën dhe trafikun.
- (3) Matjet e një ditë në javë, në mënyrë rastësore, të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit, ose tetë javë të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit.
- (4) Një matje në javë në mënyrë rastësore, të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit, ose tetë javë të shpërndara njëtrajtësisht gjatë vitit.

Pasiguria (me besueshmëri 95 %) e metodave të vlerësimit do të vlerësohet në përputhje me parimet e SSH ENV 13005-1999, në lidhje me Shprehjen e Pasigurisë në Matje, me metodologjinë e [S SH ISO 5725-1:2008](#) - 2, 3, 4, 5, 6 dhe me udhëzuesin e dhënë në DS CR 14377:2002 në lidhje me cilësinë e ajrit - Përqasja për Vlerësimin e Pasigurisë për Metodën e Matjes Referencë për Ajrin e Mjedisit'. Përqindjet e pasigurisë në tabelën e mësipërme jepen për matjet individuale të mesatarizuara për periudhën e konsideruar nga vlera kufi (ose vlera e synuar në rastin e ozonit), për një intervalconfidences besueshmërie prej 95 %. Pasiguria për matjet fikse konsiderohet e zbatueshme rrotull masës së përshtatshme të vlerës kufi (ose vlerës së synuar në rastin e ozonit).

Pasiguria për modelimin përcaktohet si shmangia maksimale (prej vlerës kufi ose prej vlerës së synuar në rastin e ozonit) e niveleve të përqendrimit të matur dhe të llogaritur gjatë periudhës në fjalë për 90 % të pikave individuale të monitorimit, pa marrë parasysh kohën e ndodhjes së ngjarjeve. Pasiguria për modelimin konsiderohet si e zbatueshme rrotull masës së përshtatshme të vlerës kufi ose vlerës së synuar në rastin e ozonit. Matjet fikse që duhen përzgjedhur për krahasim me rezultatet e modelimit duhet të jenë përfaqësuese të shkallës së mbulimit nga modeli.

Pasiguria për vlerësimin objektiv përcaktohet si shmangia maksimale (prej vlerës kufi ose prej vlerës së synuar në rastin e ozonit) e niveleve të matur dhe të llogaritur të përqendrimit gjatë periudhës në fjalë, pa marrë parasysh kohën e ndodhjes së ngjarjeve.

Kërkesat për sigurimin e të dhënave minimale dhe mbulimi kohor nuk përfshijnë humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt apo mirëmbajtjes normale të instrumentave.

Seksioni B. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së ajrit

Informacioni i mëposhtëm hartohet për zonat dhe aglomeratët ku, për vlerësimin e cilësisë së ajrit, përdoren burime të jera të cilat mund të plotësojnë informacionin e siguruar nga matjet, por mund të përdoren edhe si mënyra e vetme:

- a) përshkrimi i aktiviteteve të kryera për vlerësimin;
- b) metodat specifike që janë përdorur, me referenca për përshkrimet e metodës;
- c) burimet e të dhënave dhe informacionit;
- d) përshkrimi i rezultateve, përfshirë pasiguritë dhe, në veçanti
 - i. shtrirjen e çdo zone apo gjatësinë e rrugës brenda zonave dhe aglomeratëve përgjatë të cilës përqendrimet kapërcejnë sipas rastit vlerën kufi, vlerën e synuar apo objektivin afatgjatë plus marzhin e tolerancës, dhe
 - ii. shtrirjen e çdo zone ku përqendrimet kapërcejnë pragun e sipërm ose të poshtëm të vlerësimit;
- e) popullsia potencialisht e ekspozuar ndaj niveleve që kapërcejnë cilëndo vlerë kufi për mbrojtjen e shëndetit publik.

Seksioni C. Sigurimi i cilësisë për cilësinë e ajrit të mjedisit: vlefshmëria e të dhënave

1. Për të siguruar saktësinë e matjeve dhe përputhshmërinë me objektivat për cilësinë e të dhënave të përcaktuara në Seksionin A, AKM siguron që:
 - a) të gjitha matjet e ndërmarra në lidhje me vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në bazë të Seksioneve V dhe VII të jenë të gjurmueshme në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Seksionin 5.6.2.2 të S SH EN ISO/IEC 17025:2005 dhe S SH EN ISO/IEC 17025:2005/AC:2006;
 - b) institucionet që operojnë rrjete dhe stacione individuale të ngrenë sisteme të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë, të cilët për të garantuar saktësinë e mjeteve matëse kërkojnë mirëmbajtje të rregullt;
 - c) të funksionojë kontrolli dhe sigurimi i cilësisë për procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave dhe që institucionet e caktuara me këtë detyrë të marrin pjesë në mënyrë aktive në programet përkatëse mbarë Komunitare për sigurimin e cilësisë;
 - d) deri në vitin 2010 laboratorët kombëtarë të akreditohen sipas S SH EN ISO/IEC 17025:2005 dhe S SH EN ISO/IEC 17025:2005/AC:2006 për metodat referencë të referuara në Aneksin VI të këtij vendimi. Këta laboratorë koordinojnë në nivel kombëtar realizimin sic duhet të metodave referencë dhe demonstrimin e ekuivalencës së metodave jo-referencë.

2. Të gjitha të dhënat për cilësinë e ajrit të mjedisit të raportuara sipas draft ligjit nr. datë...”Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër” nenit 12, paragrafit 1 dhe nenit 13, paragrafi 1 do të konsiderohen të vlefshme me përjashtim të të dhënave të shënjuara si të përkohshme.

ANEKSI II.

Përcaktimi i kërkesave për vlerësimin e përqendrimeve të dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, lëndës së ngurtë pezull (PM₁₀ dhe PM_{2,5}), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit brenda një zone ose aglomerati

(Referuar në paragrafin 3.1 dhe 3.4 të këtij Vendimi)

Seksioni A. Pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit

Për ndotësit e mëposhtëm zbatohen këto pragje të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit:

1. Dioksidi i squfurit

	Mbrojtja e shëndetit	Mbrojtja e bimësisë
Pragu i Sipërm i Vlerësimit	60 % e vlerës kufi 24-orëshe (75 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se sa 3 herë në një vit kalendarik)	60 % e nivelit kritik të dimrit (12 µg/m ³)
Pragu i Poshtëm i Vlerësimit	40 % të vlerës kufi 24-orëshe (50 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 3 herë në një vit kalendarik)	40 % nivelit kritik të dimrit (8 µg/m ³)

2. Dioksidi i azotit dhe oksidet e azotit

	Vlera kufi orare për mbrojtjen e shëndetit publik (NO ₂)	Vlera kufi vjetore për mbrojtjen e shëndetit publik (NO ₂)	Niveli kritik vjetor për mbrojtjen e bimësisë dhe ekosistemeve natyrore (NO _x)
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (140 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 18 herë në një vit kalendarik)	80 % e vlerës kufi (32 µg/m ³)	80 % e nivelit kritik (24 µg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	50 % e vlerës kufi (100 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 18 herë në një vit kalendarik)	65 % e vlerës kufi (26 µg/m ³)	65 % e nivelit kritik (19,5 µg/m ³)

3. Lënda e ngurtë pezull (PM₁₀/ PM_{2,5})

	Mesatarja 24-orëshe e PM ₁₀	Mesatarja vjetore e PM ₁₀	Mesatarja vjetore e PM _{2,5} (1)
Pragu i Sipërm i Vlerësimit	70 % e vlerës kufi (35 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 35 herë në një vit kalendarik)	70 % e vlerës kufi së (28 µg/m ³)	70 % e vlerës kufi të (17 µg/m ³)
Pragu i Poshtëm i Vlerësimit	50 % e vlerës kufi (25 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 35 herë në një vit kalendarik)	50 % e vlerës kufi (20 µg/m ³)	50 % e vlerës kufi (12 µg/m ³)

(1) Pragu i sipërm dhe i poshtëm i vlerësimit për PM_{2,5} nuk zbatohen në matjet që bëhen për vlerësimin e përputhshmërisë me synimin për pakësimin e ekspozimit ndaj PM_{2,5} për mbrojtjen e shëndetit publik.

4. Plumbi

	Mesatarja vjetore
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (0,35 µg/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	50 % e vlerës kufi (0,25 µg/m ³)

5. Benzeni

	Mesatarja vjetore
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (3,5 µg/ m ³)
Pragu i Poshtëm i vlerësimit	40 % e vlerës kufi (2 µg/ m ³)

6. Monoksidi i karbonit

	Mesatarja e tetë orëve
Pragu i sipërm i vlerësimit	70 % e vlerës kufi (7 mg/ m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit	50 % e vlerës kufi (5 mg/ m ³)

Seksioni B. Përcaktimi i kapërcimeve të pragut të sipërm dhe të poshtëm të vlerësimit

Kapërcimet e pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit përcaktohen në bazë të përqendrimeve gjatë 5 viteve të mëparshme, kur disponohen të dhëna të mjaftueshme. Pragu i vlerësimit konsiderohet si i kapërcyer në qoftë se është kapërcyer gjatë të paktën 3 nga pesë vitet e mëparshme.

Kur të dhënat disponohen për më pak se 5 vjet, për të përcaktuar kapërcimet e pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit, AKM mund të kombinojë fushata të shkurtra matjesh në kohën dhe vendndodhjet më tipike për nivelet maksimale të ndotjes, me rezultatet e përfuara nga informacioni që japin inventarët e shkarkimit dhe modelimi.

ANEKSI III.

Vlerësimi i cilësisë së ajrit të mjedisit dhe vendodhja e pikave të marrjes së mostrave për matjen e dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, lëndës së ngurtë pezull (PM₁₀ dhe PM_{2,5}), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit

(Referuar në paragrafin 4.5, 5.1, 17.3, 19.1, 24.1.b, 26.3 dhe Aneksit IV.C.1 dhe Aneksit VIII.B dhe D të këtij vendimi)

Seksioni A. Të përgjithshme

Cilësia e ajrit të mjedisit vlerësohet në të gjitha zonat dhe aglomeratët sipas kriterëve të mëposhtme:

1. Cilësia e ajrit të mjedisit në të gjitha vendndodhjet, me përjashtim të atyre të listuara në paragrafin 2, vlerësohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Seksionet B dhe C për vendndodhjen e pikave të marrjes së mostrave për matje fikse. Parimet e përcaktuara nga Seksionet B dhe C zbatohen për identifikimin e vendndodhjeve specifike me përqendrimet të ndotësve përkatës ku cilësia e ajrit të mjedisit vlerësohet me matje treguese ose modelim.
2. Përputhshmëria me vlerat kufi në drejtim të mbrojtjes së shëndetit publik nuk vlerësohet në vendndodhjet e mëposhtme:
 - a) brenda territoreve ku publiku nuk ka akses dhe nuk ka vendbanime të përherëshme;
 - a) në përputhje me përkufizimin e ‘ajrit të mjedisit’ të dhënë në ligjin nr. datë “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër”, në mjediset e fabrikave ose instalimeve industriale ku zbatohen të gjitha dispozitat përkatëse në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë;
 - b) në karrexhatat e rrugëve; dhe në pjesët qendrore të rrugëve përjashtuar ato ku normalisht kanë akses këmbësorët.

Seksioni B. Përcaktimi i territorit të pikave për marrjen e mostrave në shkallë makro

1. Mbrojtja e shëndetit publik:
 - a) Pikat për marrjen e mostrave për mbrojtjen e shëndetit publik vendosen në mënyrë të tillë që të japin të dhëna për sa më poshtë:
 - i. territoret brenda zonave dhe aglomeratëve ku ndodhin përqendrimet më të larta, ndaj të cilave popullsia ka gjasa të jetë e ekspozuar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi për një periudhë kohore të konsiderueshme krahasuar me periudhën mesatare të vlerës/ave kufi;
 - ii. nivelet në territore të tjera brenda zonave dhe aglomeratëve që janë përfaqësues të ekspozimit të popullsisë në përgjithësi.
 - b) Pikat për marrjen e mostrave në përgjithësi duhen vendosur në mënyrë të tillë që të shmanget matja në mikro-mjedise shumë të vogla direkt pranë tyre, që do të thotë që pika për marrjen e mostrave duhet vendosur në mënyrë të tillë që ajri i marrë si mostër të jetë përfaqësues i cilësisë së ajrit në një segment rruge jo më pak se 100 m

të gjatë në zonat me trafik dhe i një sipërfaqe prej të paktën 250 m × 250 m në zonat industriale, cilido rast që të jetë i mundur;

- c) Vendndodhjet me karakter urban caktohen në mënyrë të tillë që niveli i ndotjes të influencohet nga kontributi i integruar i të gjitha burimeve që ndodhen në drejtim të kundërt me erën në lidhje me stacionin. Niveli i ndotjes nuk duhet dominuar nga një burim i vetëm po qe se një situatë e tillë nuk është tipike për një zonë më të madhe urbane. Këto pika për marrjen e mostrave, si rregull i përgjithshëm, duhet të jenë përfaqësuese për disa kilometra katrorë;
- d) Kur vlerësohen nivelet në sfond rural, pika për marrjen e mostrave nuk duhet të influencohet nga aglomeratët ose zonat industriale në afërsi të saj, që do të thotë zona më afër se 5 kilometra;
- e) Kur vlerësohen kontributet e zonave industriale, të paktën një pikë për marrjen e mostrave instalohet në zonën më të afërt të banimit në drejtimin e erës në lidhje me burimin. Kur nuk njihet përqëndrimi në sfond vendoset një pikë shtesë për marrjen e mostrave brenda drejtimit kryesor të erës;
- f) Pikat për marrjen e mostrave, kudo që është e mundur, do të jenë gjithashtu përfaqësuese të territoreve të ngjashme jo direkt pranë tyre;
- g) Kur është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik duhet konsideruar edhe nevoja për të caktuar pikat e marrjes së mostrave në ishuj.

2. Mbrojtja e bimësisë dhe ekosistemeve natyrore

- a) Pikat e marrjes së mostrave për mbrojtjen e bimësisë dhe ekosistemeve natyrore duhet të vendosen më larg se 20 km prej zonave dhe aglomeratëve ose më larg se 5 km prej zonave të tjera të urbanizuara, instalimeve industriale, rrugëve automobilistike apo rrugëve kryesore me trafik të llogaritur prej më shumë se 50000 automjete në ditë, që do të thotë se një pikë për marrjen e mostrave vendoset në mënyrë të tillë që ajri i marrë si mostër të jetë përfaqësues i cilësisë së ajrit në zonën përreth prej të paktën 1000 km². Duke konsideruar kushtet gjeografike apo mundësinë për të mbrojtur zona veçanërisht të rrezikuara AKM mund të sigurojë që pika për marrjen e mostrave të vendoset në distancë më të vogël apo të jetë përfaqësuese e cilësisë së ajrit në një zonë me shtrirje më të vogël.
- b) Duhet konsideruar nevoja për të vlerësuar cilësinë e ajrit në ishuj.

Seksioni C. Përcaktimi i territorit të pikave për marrjen e mostrave në shkallë mikro

1. Për aq sa është praktikisht e mundur, zbatohet sa më poshtë:
 - a) hapësira rreth grykës së sondës për marrjen e mostrave është e pakufizuar (e lirë në një hark prej të paktën 270°) nga pengesa që ndikojnë futjen e ajrit në afërsi të marrësit të mostrës (normalisht disa metra larg ndërtesave, ballkonëve, pemëve dhe pengesave të tjera dhe të paktën 0,5 m nga ndërtesa më e afërt në rastin e pikave të marrjes së mostrave që përfaqësojnë cilësinë e ajrit në vijën e ndërtesës);
 - b) në përgjithësi, pika e marrjes së mostrave duhet të jetë midis 1,5 m (niveli i frymëmarrjes) dhe 4 m mbi tokë. Në disa rrethana mund të jenë të nevojshme pozicione më të larta (deri në 8 m). Një pozicion akoma më i lartë se kaq mund të jetë gjithashtu i përshtatshëm në qoftë se stacioni është përfaqësues i një zone të madhe;
 - c) me qëllim që të shmanget futja direkte e shkarkimeve që nuk janë përzier me ajrin e mjedisit sonda hyrëse nuk vendoset ngjitur me burimet;
 - d) gryka dalëse e shkarkimit të mostrës pozicionohet në mënyrë të tillë që të shmanget riqarkullimi i ajrit të shkarkuar në hyrjen e mostrës;
 - e) për të gjithë ndotësit, sondat e marrjes së mostrave në zonë trafiku vendosen të paktën 25 m nga kryqëzimet e mëdha dhe jo më shumë se 10 m nga skaji i trotuarit.

2. Gjithashtu, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:
 - a) burimet interferuese;
 - b) siguria;
 - c) aksesit;
 - d) aksesit në rrjetin e energjisë elektrike dhe të telefonisë;
 - e) vizibiliteti i territorit në lidhje me zonat përreth tij;
 - f) siguria e publikut dhe operatorëve;
 - g) preferenca për pika integrale për marrjen e mostrave për ndotës të ndryshëm;
 - h) nevoja për planifikim.

Seksioni D. Dokumentacioni dhe rishikimi i përzgjedhjes së territorit

1. Në fazën e klasifikimit procedurat për përzgjedhjen e pikave së marrjes së mostrës dokumentohen plotësisht me mjete të tilla si fotografitë e zonës përreth dhe harta e detajuar. Këto pika rishikohen në intervale të rregullta me dokumentacion të përsëritur për të siguruar që kriteret e përzgjedhjes të mbeten të vlefshme gjatë gjithë kohës.

ANEKSI IV

Matjet në vendndodhje me karakter rural pavarësisht nga përqëndrimi

(Referuar në paragrafin 4.7.d të këtij Vendimi)

Seksioni A. Objektivat

Objektiv kryesor i këtyre matjeve është që të sigurojnë informacionin e duhur për nivelet në sfond. Ky informacion është thelbësor për të gjykuar rritjen e këtyre niveleve në zonat më shumë të ndotura (si zona me karakter urban, zonat e lidhura me industrinë, zonat e lidhura me trafikun), për të vlerësuar kontributin e mundshëm nga transporti i ndotësve të ajrit në distancë të largët, për të mbështetur analizën e përhapjes nga burimi dhe për të kuptuar ndotësit specifikë siç është lënda e ngurtë pezull. Ky informacion është gjithashtu thelbësor për të garantuar më shumë përdorim të modelimit në zonat urbane.

Seksioni B. Substancat

Për të karakterizuar përbërjen e vet kimike matja e $PM_{2,5}$ duhet të përfshijë të paktën përqëndrimin e masës totale dhe përqëndrimet e përbërësve të duhur. Kjo matje duhet të përfshijë të paktën listën e llojeve të kimikateve të dhëna më poshtë:

SO_4^{2-}	Na^+	NH_4^+	Ca^{2+}	Karbon elemental (EC)
NO_3^-	K^+	Cl^-	Mg^{2+}	Karbon organik (OC).

Seksioni C. Përcaktimi i vendit për matje

1. Matjet duhen kryer vecanërisht në zona rurale në përputhje me Seksionin A, b dhe C të Aneksit III të këtij Vendimi.

ANEKSI V.

Kriteret për përcaktimin e numrave minimal të pikave për marrjen e mostrave për matjet fikse të përqëndrimit të dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, lëndës së ngurtë pezull (PM₁₀, PM_{2,5}), plumbit, benzenit dhe monoksidit të karbonit në ajrin e mjedisit

(Referuar në paragrafin 5.2, 5.3, 19.2, 24.1.c, dhe Aneksin XIV.A.1 të këtij Vendimi)

A. Numri minimal i pikave për marrjen e mostrave për matje fikse për vlerësimin e përputhshmërisë me vlerat kufi për mbrojtjen e shëndetit publik dhe pragjet e alarmit në zona dhe aglomeratë ku matja fikse është burimi i vetëm i informacionit.

1. Burimet e shpërndarjes

Popullsia e zonës ose aglomeratit (mijë)	Në qoftë se përqëndrimet maksimale kapërcejnë pragun e sipërm të vlerësimit (1)		Në qoftë se përqëndrimet maksimale janë midis pragut të sipërm dhe të poshtëm të vlerësimit	
	Ndotësit përveç PM	PM (2) (shuma e PM ₁₀ dhe PM _{2,5})	Ndotësit përveç PM	PM (2) (shuma e PM ₁₀ dhe PM _{2,5})
0-249	1	2	1	1
250-499	2	3	1	2
500-749	2	3	1	2
750-999	3	4	1	2
1 000-1 499	4	6	2	3
1 500-1 999	5	7	2	3
2 000-2 749	6	8	3	4
2 750-3 749	7	10	3	4
3 750-4 749	8	11	3	6
4 750-5 999	9	13	4	6
≥ 6 000	10	15	4	7

(1) Për dioksidin e azotit, lëndën e ngurtë pezull, benzenin dhe monoksidin e karbonit: të përfshihet të paktën një stacion monitorimi për zonat urbane dhe një stacion i orientuar nga trafiku me kusht që numri i pikave të marrjes së mostrave të mos rritet. Për këta ndotës, numri total i stacioneve në zona urbane dhe numri total i stacioneve të orientuara nga trafiku në Republikën e Shqipërisë sic kërkohet nga Seksioni A(1) nuk ndryshon me më shumë se 2 herë. Pikat e marrjes së mostrave ku në 3 vitet e fundit ka pasur kapërcime të vlerës kufi të PM₁₀ ruhen, përveç se kur ndryshimi i vendit bëhet i nevojshëm të rrethanave të vecanta, sidomos nga zhvillimi hapësinor.

(2) Kur PM_{2,5} and PM₁₀ maten në të njëjtin stacion monitorimi, këto do të numërohen si dy pika të veçanta monitorimi. Numri total i pikave të monitorimit PM_{2,5} dhe PM₁₀ në Republikën e Shqipërisë që kërkohet nga Seksioni A(1) nuk ndryshon me më shumë se 2 herë, dhe numri i pikave të monitorimit të PM_{2,5} në mjedise urbane të aglomeratëve dhe zonave urbane plotëson kërkesat sipas Seksionit B të mëposhtëm.

2. Burimet e identifikueshme

Për vlerësimin e ndotjes në afërsi të burimeve identifikueshme, numri i pikave për marrjen e mostrave për matje fikse llogaritet duke marrë në konsideratë dendësitë e shkarkimit, modelet e shpërndarjes së mundshme të ndotjes së ajrit të mjedisit dhe ekspozimin potencial të popullsisë.

B. Numri minimal i pikave të marrjes së mostrave për matje fikse për të vlerësuar përputhshmërinë me synimin për pakësimin e ekspozimit ndaj PM_{2,5} për mbrojtjen e shëndetit publik.

Për këtë qëllim operohet me një pikë për marrje mostrash për një milionë banorë që përmbledh aglomeratët dhe zonat urbane që kanë më shumë se 100 000 banorë. Këto pika për marrjen e mostrave mund të përkojnë me pikat e marrjes së mostrave sipas Seksionit A më sipër.

C. Numri minimal i pikave të marrjes së mostrave për matje fikse për të vlerësuar përputhshmërinë e niveleve kritike për mbrojtjen e bimësisë në zonat përveç aglomeratëve.

Në qoftë se përqëndrimet maksimale kapërcejnë pragun e sipërm të vlerësimit	Në qoftë se përqëndrimet janë midis pragut të sipërm dhe të poshtëm të vlerësimit
1 stacion cdo 14 000 km ²	1 stacion cdo 28 000 km ²

Për monitorimin e cilësisë së ajrit në ishull numri i pikave të marrjes së mostrave për matjet fikse llogaritet duke marrë parasysh modelet e shpërndarjes së mundshme të ndotjes së ajrit të mjedisit dhe ekpozimin potencial të bimësisë.

ANEKSI VI.

Metodat referencë për vlerësimin e përqendrimeve të dioksidit të squfurit, dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit, lëndës së ngurtë pezull (PM₁₀ AND PM_{2,5}), plumbit, benzenit, monoksidit të karbonit dhe ozonit

(Referuar në paragrafin 6.1, 6.2, 9.1, 9.2, Aneksi I.C.d i këtij Vendimi)

Seksioni A. Metodat referencë të matjes

1. Metodat referencë për matjen e dioksidit të squfurit

Metoda referencë për matjen e dioksidit të squfurit është ajo që përshkruhet në EN 14212:2005 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metoda standard për matjen e përqendrimit të dioksidit të squfurit nga fluoreshenca ultravjollcë”.

2. Metoda referencë për matjen e dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit

Metoda referencë për matjen e dioksidit të azotit dhe oksideve të azotit është ajo që përshkruhet në EN 14211:2005 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metoda standarde për matjen e përqendrimit të dioksidit të azotit dhe monoksidit të azotit nga kimiluminishenca”.

3. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e plumbit

Metoda referencë për marrjen e mostrave të plumbit është ajo e përshkruar në Seksionin A(4) të këtij Aneksi. Metoda referencë për matjen e plumbit është ajo që përshkruhet në S SH EN 14902:2005 dhe S SH EN 14902:2005/AC:2006 “Metoda standarde për matjen e Pb/Cd/As/Ni në fraksionin PM₁₀ të lëndës së ngurtë pezull”.

4. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e PM₁₀

Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e PM₁₀ është ajo që përshkruhet në EN 12341:2005 “Cilësia e Ajrit — Përcaktimi i fraksionit PM₁₀ i lëndës së ngurtë pezull — Metoda referencë dhe procedura e testimit në terren për të provuar ekuivalencën referencë të metodave të matjes”.

5. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e PM_{2,5}

Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e PM_{2,5} është ajo që përshkruhet në S SH EN 14907:2005 “Metoda e matjeve standarde gravimetrike për përcaktimin e fraksionit të masës PM_{2,5} të lëndës së ngurtë pezull”.

6. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe matjen e benzenit

Metoda referencë për matjen e benzenit është ajo që përshkruhet në S SH EN 14662:2005, pjesa 1, 2, 3, 4 dhe 5 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metoda standarde për matjen e përqendrimeve të benzenit”.

7. Metoda referencë për matjen e monoksidit të karbonit

Metoda referencë për matjen e monoksidit të karbonit është ajo që përshkruhet në EN 14626:2005 “Cilësia e ajrit të mjedisit — Metoda standarde për matjen e përqendrimit të monoksidit të karbonit nga spektroskopi me rreze infra të kuqe jo shpërndarëse”.

8. Metoda reference për matjen e ozonit

Metoda referencë për matjen e ozonit është ajo që përshkruhet në EN 14625:2005 ‘Cilësinë e ajrit të mjedisit — Metoda standarde për matjen e përqendrimit të ozonit nga fotometria ultravjollcë’.

Seksioni B. Demonstrimi i ekuivalencës

1. AKM mund të përdorë çdo metodë tjetër që mund të demonstrojë se jep rezultate ekuivalente me ndonjë nga metodat e referuara në Seksionin A ose, në rastin e lëndës së ngurtë pezull, çdo metodë tjetër që AKM mund të demonstrojë se shfaq marrëdhënie të qendrueshme me metodën referencë. Në këtë rast, për të prodhuar rezultate ekuivalente me ato që do të ishin arritur përmes metodës reference, rezultatet e arritura nga ajo metodë duhet të korrigjohen.
2. AKM përgatit, publikon dhe bën të disponueshëm për publikun raportin për demonstrimin e ekuivalencës në përputhje me paragrafin 1.

Seksioni C. Standardizimi

1. Për ndotësit e gaztë vëllimi standardizohet në temperaturë 293 K dhe trysni atmosferike 101,3 kPa.
2. Për lëndën e ngurtë pezull dhe substancat që do të analizohen në lëndën e ngurtë pezull (p.sh. plumbi) vëllimi i mostrave që marren i referohet kushteve të mjedisit: temperaturës dhe trysnisë atmosferike në datën e matjeve.

Seksioni D. Prezantimi i paisjeve të reja

1. Të gjitha paisjet e reja që do të prokurohen për zbatimin e këtij Vendimi duhet të jenë në përputhje me metodën referencë apo ekuivalentin e saj jo më vonë se 11 Qershor 2020.
2. Të gjitha paisjet e përdorura në matjet fikse duhet të jenë në përputhje me metodën referencë apo ekuivalentin e saj jo më vonë se 11 Qershor 2023.

Seksioni E. Njohja reciproke e të dhënave

1. Për miratimin e përputhshmërisë së pajisjes me kërkesat e performancës së metodave referencë të listuara në Seksionin A të këtij Aneksi, AKM pranon raportet e testimit të lëshuara në Shtete të tjera nga laboratorë të akredituar me S SH EN ISO/IEC 17025:2005 dhe S SH EN ISO/IEC 17025:2005/AC:2006 për kryerjen e testimeve të tilla.

ANEKSI VII.

Vlerat e synuara të ozonit dhe objektivat afatgjatë

(Referuar në paragrafin 2 të Aneksit III të draft ligjit nr..... datë... “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër; paragrafi 7.1 dhe 20.1.a të këtij Vendimi)

Seksioni A. Përkufizime dhe kritere

1. Përkufizimet

AOT40 (shprehur $(\mu\text{g}/\text{m}^3) \cdot \text{orë}$) është shuma e diferencave të përqendrimeve orare mbi $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ (= 40 pjesë për billion) me $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$ gjatë një periudhe kohore të dhënë, duke përdorur vetëm vlerat një orëshe të matura cdo ditë midis orës 8.00 dhe 20.00.

2. Kriteret

Kriteret e mëposhtme përdoren për të kontrolluar vlefshmërinë kur agregohen të dhënat dhe llogariten parametrat statistikorë:

Parametri	Proporcioni i kërkuar i të dhënave të vlefshme
Vlera një orëshe	75 % (dmth 45 minuta)
Vlera tetë orëshe	75 % e vlerave (dmth 6 orë)
Mesatarja maksimale ditore 8 orëshe nga 8 orë njëra pas tjetrës	75 % e mesatares për orë e tetë orëve njëra pas tjetrës (dmth 18 mesatare tetë orëshe në ditë)
AOT40	90 % e vlerave një orëshe gjatë periudhës kohore të përcaktuar për llogaritjen e vlerës AOT40 (1)
Mesatarja vjetore	75 % e vlerave një orëshe gjatë verës (Prill deri në Shtator) dhe 75 % gjatë dimrit (Janar deri në Mars, Tetor deri në Dhjetor) vec e vec
Numri i kapërcimeve dhe vlerat maksimale për muaj	90 % të vlerave maksimale mesatare tetë orëshe të cdo dite (27 vlera ditore të disponueshme për muaj) 90 % e vlerave një orëshe ndërmjet orës 8.00 dhe 20.00
Numri i kapërcimeve dhe vlera maksimale për vit	5 nga 6 muaj gjatë stinës së verës (Prill deri Shtator)
(1) Kur nuk disponohen të gjitha të dhënat e matura të mundshme, për të llogaritur vlerat AOT40 përdoret faktori i mëposhtëm: AOT40 e llogaritur = AOT40 e matur \times numri total i mundshëm i orëve (*)/numri i vlerave të matura për orë. (*)numri i orëve brenda periudhës kohore të përkufizimit të AOT40, (që do të thotë 08:00 deri në 20:00 nga 1 Maj deri në 31 Korrik cdo vit, për mbrojtjen e bimësisë dhe nga 1 Prill deri në 30 Shtator cdo vit për mbrojtjen e pyjeve).	

Seksioni B. Vlerat e synuara

Objekti	Periudha mesatare	Vlera e synuar	Data kur duhet arritur vlera e synuar (1)
Mbrojtja e shëndetit publik	Mesatarja maksimale tetë orëshe gjatë ditës (2)	$120 \mu\text{g}/\text{m}^3$ të mos kapërcehet në më shumë se 25 ditë një për vit kalendarik të mesatarizuar gjatë 3 vjetëve (3)	1.1.2020
Mbrojtja e bimësisë	Maj deri në Korrik	AOT40 (llogaritur nga vlera 1 orëshe) $18\,000 \mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$ mesatarizuar gjatë 5 vjetëve (3)	1.1.2020
(1) Përputhshmëria me vlerat e synuara do të vlerësohet duke filluar nga kjo datë. Kjo do të thotë që, 2020 do të jetë viti i parë të dhënat e të cilat do të përdoren për të llogaritur përputhshmërinë gjatë 3 apo 5 viteve vijuese, sipas rastit.			
(2) Përqendrimi i mesatares maksimale ditore tetë orëshe do të përzgjidhet duke ekzaminuar mesataret e tetë orëve njëra pas tjetrës, llogaritur nga të dhënat për orë dhe të përditësuara cdo orë. Çdo mesatare tetë orëshe e llogaritur kështu do t'i caktohet ditës në të cilën mbaron që do të thotë periudha e parë e llogaritjes për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 17:00 e ditës së mëparshme deri në orën 01:00 të asaj dite; periudha e fundit e llogaritjes për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 16:00 deri në orën 24:00 të asaj dite.			
(3) Nëse mesataret 3 apo 5 vjetore nuk mund të përcaktohen në bazë të një kompleti të plotë dhe të vijueshëm të dhënash vjetore, të dhënat vjetore minimale të kërkuara për të kontrolluar përputhshmërinë me vlerat e synuara do të jenë si më poshtë: — për vlerat e synuara për mbrojtjen e shëndetit publik: të dhënat e vlefshme për 1 vit, — për vlerën e synuar për mbrojtjen e bimësisë: të dhënat e vlefshme për 3 vjet			

Seksioni C. Objektivat afatgjatë

Objektivi	Periudha mesatare	Objektivi afatgjatë	Data kur duhet të arrihet objektivi afatgjatë
Mbrojtja e shëndetit publik	Mesatarja maksimale ditore tetë orëshe brenda një viti kalendarik	120 $\mu\text{g}/\text{m}^3$???
Mbrojtja e bimësisë	Maj deri në Korrik	AOT40 (llogaritur nga vlerat 1 orëshe) 6 000 $\mu\text{g}/\text{m}^3 \cdot \text{h}$???

ANEKSI VIII.

Kriteret për klasifikimin dhe përcaktimin e pikave të marrjes së mostrave për vlerësimin e përqendrimeve të ozonit

(Referuar në paragrafin 8.1 dhe 8.3 të këtij Vendimi)

Për matjet fikse zbatohen sa më poshtë:

A. Përcaktimi i vendndodhjes në shkallë makro

Lloji i stacionit	Objektivat e matjes	Përfaqësueshmëria (1)	Kriteret e përcaktimit të vendndodhjes në shkallë makro
Urban	Mbrojtja e shëndetit publik: të vlerësojë ekspozimin e popullsisë urbane ndaj ozonit, që do të thotë kur densiteti i popullsisë dhe përqendrimi i ozonit janë relativisht të larta dhe përfaqësuese të ekspozimit të publikut në përgjithësi	Disa km ²	Larg influencës së shkarkimeve lokale si trafiku, pikat e furnizimit me karburant, etj.; Vendet e ventiluara ku mund të maten nivelet e përzjera mirë; Vendet si zonat e banimit dhe zonat tregtare të qyteteve, parqeve (larg nga pemët), rrugët apo sheshet e mëdha me shumë pak ose aspak trafik, zonat e hapura karakteristike për infrastruktura të arsimit, sportit ose shplohëse
Nënrurban	Mbrojtja e shëndetit publik dhe bimësisë: të vlerësojë ekspozimin e popullsisë dhe bimësisë që ndodhet në periferi të aglomeratit, ku janë nivelet më të larta të ozonit, ndaj të cilët popullsia dhe bimësia kanë gjasa të jenë të ekspozuar drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti	Disa dhjetra km ²	Në një distancë të caktuar nga zona e shkarkimeve maksimale, në drejtim të erës sipas drejtimit/drejtimeve kryesore të erës gjatë kushteve të favorshme për formimin e ozonit; kur popullsia, kulturat bujqësore të ndjeshme apo ekosistemet natyrore që ndodhen në perimetrin e jashtëm të një aglomerati janë të ekspozuar ndaj niveleve të larta të ozonit; sipas rastit, disa stacione nënrurbane gjithashtu në drejtim të kundërt të erës së shkarkimeve maksimale me qëllim që të përcaktohen nivelet rajonale të ozonit
Rural	Mbrojtja e shëndetit publik dhe bimësisë: të vlerësojë ekspozimin e popullsisë, të kulturave bujqësore dhe ekosistemeve natyrore ndaj përqendrimeve të ozonit në shkallë nën- rajonale	Nivelet nën-rajonale (disa qindra km ²)	Stacionet mund të vendosen në qendra të vogla banimi dhe /ose zona me ekosisteme natyrore, me pyje ose me kultura bujqësore; në vende përfaqësues për ozonin, larg nga ndikimi i shkarkimeve lokale të menjëhershme siç janë instalimet industriale dhe rrugët; në vende të hapura, por jo në majat e maleve më të larta
Sfond rural	Mbrojtja e bimësisë dhe shëndetit publik: të vlerësojë ekspozimin e kulturave bujqësore dhe ekosistemeve natyrore ndaj përqendrimeve të ozonit në shkallë rajonale si edhe ekspozimin e popullsisë	Nivel Rajonal/ kombëtar/ kontinenti (1 000 deri në 10 000 km ²)	Stacioni vendoset në zona me densitet më të ulët popullsie, p.sh. me ekosisteme natyrore, pyje, në një distancë prej të paktën 20 km nga zonat urbane dhe industriale dhe larg nga shkarkimet lokale; të shmangen vendndodhjet që janë objekt i formimit të shtuar lokalisht të kushteve të kundërta pranë tokës, gjithashtu majat e maleve më të larta; nuk rekomandohen zonat bregdetare me cikle erërash të përditshme të shpallura me

			karakter lokal.
(1) Kur është e mundur, pikat e marrjes së mostrave duhet të jenë përfaqësuese të territoreve të ngjashme që nuk ndodhen në afërsinë e tyre të drejtëpërdrejtë.			

Vendndodhja e stacioneve rurale dhe atyre në sfond rural, sipas rastit, do të koordinohet me kërkesat për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimet mjedisore.

B. Përcaktimi i vendndodhjes në shkallë mikro

Kur është praktikisht e mundëshme ndiqet procedura për përcaktimin e territorit në shkallë mikro sipas Seksionit C të Aneksit III të këtij vendimi, duke siguruar që sonda hyrëse pozicionohet tepër larg nga burime të tilla si furnalta dhe oxhakë incineratorësh dhe mbi 10m larg nga rruga më e afërt, me distancë që rritet në funksion të intensitetit të trafikut.

C. Dokumentacioni dhe rishikimi i vendndodhjes së përzgjedhur

Për këtë qëllim zbatohen procedurat që jepen në Seksionin D të Aneksit III, duke kryer ekzaminimin dhe interpretimin e duhur të të dhënave monitoruese në kontekstin e proceseve meteorologjike dhe fotokimike që ndikojnë përqendrimit e ozonit të matura në territoret përkatëse.

ANEKSI IX

Kriteret për përcaktimin e numrit minimal të pikave të marrjes së mostrave për matjet fikse të përqëndrimeve të ozonit

(Referuar në paragrafët 8.2, 8.3, 8.5, 8.7 të këtij Vendimi)

Seksioni A. Numri minimal i pikave për marrjen e mostrave për matjet fikse të vazhdueshme për të vlerësuar përputhshmërinë me vlerat e synuara, objektivat afatgjatë, pragjet e informimit dhe pragjet e alarmit kur matje të tilla janë burimi i vetëm i informacionit

Popullsia (× 1 000)	Aglomeratët (urbanë dhe nënurbane) (1)	Zona të tjera (nënurbane dhe rurale) (1)	Mjedisi rural
< 250		1	1 stacion/gjithë territorin e RSH si një densitet mesatar për të gjitha zonat në vend (2)
< 500	1	2	
< 1 000	2	2	
< 1 500	3	3	
< 2 000	3	4	
< 2 750	4	5	
< 3 750	5	6	
> 3 750	Një stacion shtese për 2 milion banorë	Një stacion shtese për 2 milion banorë	
(1) Të paktën 1 stacion në zonat nënurbane, ku ka gjasa të ketë ekspozim të lartë të popullsisë. Në aglomeratë të paktën 50 % e stacioneve do të vendosen në zona nënurbane.			
(2) 1 stacion për të mbuluar të gjithë vendin.			

Seksioni B. Numri minimal i pikave për marrjen e mostrave për matjet fikse për zonat dhe aglomeratët që arrijnë objektivat afatgjata

Numri i pikave për marrjen e mostrave për ozonin, në kombinim me mjete të tjera vlerësimi, siç janë modelimi i cilësisë së ajrit dhe matjet e renditura të dioksidit të azotit, është i mjaftueshëm për të ekzaminuar tendencën e ndotjes së ozonit dhe për të kontrolluar përputhshmërinë me objektivat afatgjatë. Numri i stacioneve të vendosura në aglomeratë dhe zona të tjera mund të pakësohet në një të tretën e numrit të përcaktuar në Seksionin A më sipër. Kur informacioni nga stacionet e matjeve fikse është burimi i vetëm i informacionit, duhet mbajtur të paktën një stacion monitorimi. Në qoftë se, në zonat ku ka vlerësim shtesë, del si rezultat që zonës nuk i ka asnjë stacion, koordinimi me numrin e stacioneve në zonat fqinjë do të sigurojë vlerësimin e përshtatshëm të përqëndrimeve të ozonit ndaj objektivave afatgjatë. Numri i stacioneve me karakter rural do të jetë një për të gjithë vendin.

ANEKSI X
Matjet e substancave pararendëse të ozonit

(Referuar në paragrafin 8.8, 8.9 të këtij Vendimi)

Seksioni A. Objektivat

1. Objektivat kryesore të matjeve të tilla janë: të analizojnë çdo tendencë në pararendësit e ozonit, të kontrollojnë efikasitetin e strategjive të pakësimit të shkarkimeve, të kontrollojnë konsistencën e inventarëve të shkarkimeve dhe t'ia atribuojnë përqendrimit e vëzhguara të ndotjes burimeve të shkarkimit.
2. Një qëllim tjetër është të sqarojnë si formohet ozoni, proceset pararendëse të përhapjes si dhe zbatimin e modeleve fotokimike.

Seksioni B. Substancat

1. Matja e substancave pararendëse të ozonit bëhet të paktën për oksidet e azotit (NO dhe NO₂) dhe komponimet organike të avullueshme (VOC) të duhura. Lista e komponimeve organike të avullueshme që rekomandohen për matjet jepet më poshtë:

	1-Buteni	Izopreni	Etil benzeni
Etani	Trans-2-Buteni	n-Hekzani	m + p-Ksileni
Etileni	cis-2-Buteni	i-Hekzani	o-Ksileni
Acetileni	1,3-Butadieni	n-Heptani	1,2,4-Trimetilbenzeni
Propani	n-Pentani	n-Oktani	1,2,3-Trimetilbenzeni
Propeni	i-Pentani	i-Oktani	1,3,5-Trimetilbenzeni
n-Butani	1-Penteni	Benzeni	Formaldehid
i-Butani	2-Penteni	Tolueni	Hidrokarburet totale jo -metan

Seksioni C. Përcaktimi i vendndodhjes

1. Matjet duhen kryer veçanërisht në zona urbane ose nënurbane në cdo vend monitorimi të përcaktuar në përputhje me kërkesat e këtij Vendimi dhe që konsiderohet i përshtatshëm në lidhje me objektivat e monitorimit të referuara në Seksionin A më sipër.

ANEKSI XI

Vlerat kufi për mbrojtjen e shëndetit publik

(Referuar në paragrafin 17.1, 17.2, 17.4, 17.5, 27.1, 27.3, 28.1 dhe 28.3 të këtij Vendimi)

Seksioni A. Kriteret

1. Pavarësisht nga Aneksi I i këtij vendimi, për të kontrolluar vlefshmërinë gjatë agregimit të të dhënave dhe llogaritjes së parametrave statistikore përdoren kriteret e mëposhtme:

Parametri	Proporcioni i kërkuar i të dhënave të vlefshme
Vlera një orëshe	75 % (që do të thotë 45 minuta)
Vlera tetë orëshe	75 % e vlerave (që do të thotë 6 orë)
Mesatarja maksimale ditore e tetë orëve	75 % e mesatareve për orë të tetë orëve njëra pas tjetrës (që do të thotë 18 mesatare tetë orëshe në ditë)
Vlerat 24 orëshe	75 % e mesatareve për çdo orë (që do të thotë të paktën vlerat për 18 orë)
Mesatarja vjetore	90 % (1) e vlerave një orëshe ose (nëse nuk janë të disponueshme) vlerat 24-orëshe përgjatë vitit
(1) Kërkesat për llogaritjen e mesatares vjetore nuk përfshijnë humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt apo mirëmbajtjes normale të përdorimit të instrumentave.	

Seksioni B. Vlerat kufi

Periodha mesatare	Vlera kufi	Marzhi i tolerancë	Data kur duhet të arrihet vlera kufi
Dioksidi i sqfurit			
Një orë	350 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 24 herë gjatë një viti kalendarik	150 µg/m ³ (43 %)	1 Janar 2020
Një ditë	125 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 3 herë në një vit kalendarik	Asnjë	1 Janar 2020
Dioksidi i azotit			
Një orë	200 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 18 herë gjatë një viti kalendarik	50 % më 19 Korrik 2009, që zvogëlohet në 1 Janar 2011 dhe cdo 12 muaj më pas në përqindje të barabarta vjetore për të arritur në 0 % më 1 Janar 2020	1 Janar 2020
Viti kalendarik	40 µg/m ³	50 % në 19 Korrik 2009, që zvogëlohet në 1 Janar 2011 dhe cdo 12 muaj më pas në përqindje të barabarta vjetore për të arritur në 0 % më 1 Janar 2020	1 Janar 2020
Benzeni			
Viti kalendarik	5 µg/m ³	5 µg/m ³ (100 %) më 13 Dhjetor 2010, që zvogëlohet në 1 Janar 2016 dhe cdo 12 muaj më pas me 1 µg/m ³ për të arritur në 0 % më 1 Janar 2020	1 Janar 2020
Monoksidi i karbonit			
Mesatarja mesatare ditore tetë orëshe	10 mg/m ³	60 %	1 Janar 2020
(2)			
Plumbi			
Viti kalendarik	0,5 µg/m ³ (3)	100 %	1 Janar 2020
PM₁₀			
Një ditë	50 µg/m ³ , të mos kapërcehet më shumë se 35 herë gjatë një viti	50 %	1 Janar 2030
Viti kalendarik	40 µg/m ³	20 %	1 Janar 2030
(2) Përqëndrimi mesatar ditor tetë orësh do të përzgjidhet nga ekzaminimi i mesatareve të tetë orëve njëra pas tjetrës, llogaritur nga të dhënat e çdo ore dhe të përditësuar çdo orë. Çdo mesatare tetë orëshe e llogaritur në këtë mënyrë do t'i caktohet ditës në të cilën mbaron			

Periudha mesatare	Vlera kufi	Marzhi i tolerancë	Data kur duhet të arrihet vlera kufi
që do të thotë se periudha e llogaritjes së parë për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 17:00 e ditës së mëparshme deri në orën 01:00 të asaj dite; periudha e llogaritjes së fundit për çdonjërin nga ditët do të jetë periudha nga ora 16:00 deri në orën 24:00 të asaj dite.			
(3) Vlera kufi të plotësohet vetëm më 1 Janar 2025 në afërsi të drejtpërdrejtë me burimet e zonave industriale specifike që ndodhen në territore të ndotura për dekada me rradhë nga aktivitetet industriale. Në raste të tilla, vlera kufi deri më 1 Janar 2025 do të 1,0 µg/m ³ . Zona në të cilën vlerat kufi më të larta nuk duhet të shtrihet më larg se 1 000 m nga burime të tilla specifike.			

ANEKSI XII Pragjet e informimit dhe të alarmit

(Referuar në paragrafin 21 të këtij Vendimi)

Seksioni A. Pragjet e alarmit për ndotësit, me përjashtim të ozonit

Për tu matur gjatë 3 orëve të njëpasnjëshme në territore përfaqësuese të cilësisë së ajrit përgjatë të paktën 100 km² ose një zonë ose aglomeratë të tërë, cilido qoftë më i vogli.

Ndotësit	Pragu i alarmit
Dioksidi i sqfurit	500 µg/m ³
Dioksidi i azotit	400 µg/m ³

Seksioni B. Pragjet e informimit dhe të alarmit për ozonin

Qëllimi	Periudha mesatare	Pragu
Informimi	1 orë	180 µg/m ³
Alarmi	1 orë (1)	240 µg/m ³

(1) Për zbatimin e nenit 10 të draft ligjit nr.... datë... "Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajër më të pastër" dhe paragrafit 21 të këtij vendimi, kapërcimi i pragut është për t'u matur ose parashikohet për cdo 3 orë të njëpasnjëshme

ANEKSI XIII
Nivelet kritike për mbrojtjen e bimësisë

(Referuar në paragrafin 19.1 të këtij Vendimi)

Periudha mesatare	Nivel kritik	Marzhi i tolerancës
Dioksidi i sqfurit		
Viti kalendarik dhe dimri (1 Tetor deri 31 Mars)	20 µg/m ³	Asnjë
Oksidet e azotit		
Viti kalendarik	30 µg/m ³ NOx	Asnjë

ANEKSI XIV

Synimi i pakësimit të ekspozimit kombëtar, vlera e synuar dhe vlera kufi për PM_{2,5}

(Referuar në paragrafin 17.5, 24.1.a, 25, 26.2.a, 26.1.b, 26.2.b, 26.4 të këtij Vendimi)

Seksioni A. Treguesi i ekspozimit mesatar

1. Treguesi i Ekspozimit Mesatar i shprehur në $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (TEM) bazohet në matjet në vendndodhje me karakter urban në zona dhe aglomeratë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. TEM vlerësohet si përqëndrimi mesatar vjetor i tre viteve kalendarike rresht i mesatarizuar për të gjitha pikat e marrjes së mostrave të ngritura në bazë të Seksionit B të Aneksit V të këtij vendimi. TEM për vitin 2020 do të jetë përqëndrimi mesatar i viteve 2018, 2019 dhe 2020.
2. Megjithatë nqse për vitin 2018 nuk disponohen të dhëna, AKM mund të përdorë përqëndrimin mesatar të viteve 2019 dhe 2020 ose përqëndrimin mesatar të vitit 2019, 2020 dhe 2021.
3. TEM për vitin 2030 do të jetë përqëndrimi mesatar i 3 viteve rresht mesatarizuar përgjatë gjithë pikave të marrjes së mostrave për vitet 2028, 2029 dhe 2030. TEM përdoret për të gjykuar nëse është arritur synimi për pakësimin e ekspozimit kombëtar.
4. TEM për vitin 2015 do të jetë përqëndrimin mesatar i 3 viteve rresht i mesatarizuar për të gjitha pikat e marrjes së mostrave për vitet 2023, 2024 dhe 2025. TEM përdoret për të gjykuar nëse është arritur detyrimi për përqëndrimin e ekspozimit.

Seksioni B. Synimi për pakësimin e ekspozimit kombëtar

Synimi i pakësimit të ekspozimit në lidhje me TEM në vitin 2020		Viti kur duhet të arrihet synimi për pakësimin e ekspozimit
Përqëndrimet fillestare në $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Synimi i pakësimit në përqindje	
< 8,5 = 8,5	10. 0%	2030
> 8,5 — < 13	12. 10%	
= 13 — < 18	14. 15%	
= 18 — < 22	16. 20%	
≥ 22	Të gjitha masat e duhura për të arritur 18 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	

1. Kur në vitin referencë TEM është 8,5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ ose më pak se kaq, synimi për pakësimin e ekspozimit do të jetë zero.
2. Gjatë periudhës nga 2020 deri 2030 synimi për pakësim do të jetë zero edhe kur TEM arrin nivelin 8,5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ në cdo kohë dhe mbahet në atë nivel ose nën të.

Seksioni C. Detyrimi për përqëndrimin e ekspozimit

Detyrimi për përqëndrimin e ekspozimit	Viti kur duhet të arrihet vlera e detyrimit
20. 20 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	2025

Seksioni D. Vlera e synuar

Periudha mesatare	Vlera e synuar	Data kur duhet të arrihet vlera e synuar
Viti kalendarik	25 µg/m ³	1 Janar 2020

Seksioni E. Vlera kufi

Periudha mesatare	Vlera kufi	Marzhi i tolerancës	Data në të cilën duhet të arrihet vlera kufi
Faza 1			
Viti kalendarik	25 µg/m ³	20 % më 11 Qershor 2018, që zvogëlohet në 1 Janarin e ardhshëm dhe cdo 12 muaj më pas në përqindje të barabarta vjetore për të arritur në 0 % më 1 Janar 2025	1 Janar 2025
Faza 2 (1)			
Viti kalendarik	20 µg/m ³		1 Janar 2030
(1) Faza 2 — në 2023 vlera treguese kufi do të rishikohet nga Ministri nga pikëpamja e informacionit të mëtejshëm mbi efektet në shëndet dhe mjedis, fizibilitetin teknik dhe eksperiencën me vlerën e synuar.			

ANEKSI XV

Vlerat e synuara për arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe benzo(a)pirenin

(Referuar në paragrafin 18.1, Aneksi XVII. I.4 I këtij Vendimi)

Ndotësi	Vlerat e synuara (1)
Arseniku	6 ng/m ³
Kadmiumi	5 ng/m ³
Nikeli	20 ng/m ³
Benzo(a)pireni	1 ng/m ³

(1) Për përmbajtjen totale në fraksionin PM₁₀ të mesatarizuar gjatë një viti kalendarik.

ANEKSI XVI

Përcaktimi i kërkesave për vlerësimin e përqëndrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në ajrin e mjedisit brenda një zone ose aglomerati

(Referuar në paragrafin 10.1, 10.3, 11.2, 11.3 të këtij Vendimi)

I. Pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit

Për këto ndotës do të zbatohen pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit:

	Arsenik	Kadmium	Nikel	B(a)P
Pragu i sipërm i vlerësimit në përqindje të vlerës së synuar	60 % (3,6 ng/m ³)	60 % (3 ng/m ³)	70 % (14 ng/m ³)	60 % (0,6 ng/m ³)
Pragu i poshtëm i vlerësimit në përqindje të vlerës së synuar	40 % (2,4 ng/m ³)	40 % (2 ng/m ³)	50 % (10 ng/m ³)	40 % (0,4 ng/m ³)

II. Përcaktimi i kapërcimeve të pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit

1. AKM përcakton kapërcimet e pragjeve të sipërme dhe të poshtme mbi bazën e përqëndrimeve gjatë pesë viteve kur disponohen të dhëna të mjaftueshme. Pragu i vlerësimit do të konsiderohet se është kapërcyer në qoftë se ai është kapërcyer gjatë tre nga pesë vitet e mëparshme kalendarike.
2. Kur disponohen të dhëna për më pak se pesë vjet, AKM mund të kombinojë fushatat afatshkurtër të matjeve në vende potencialisht tipike për nivelet më të larta të ndotjes gjatë vitit me rezultatet e përftuara nga informacioni i inventarëve të shkarkimeve dhe modelimi për të përcaktuar kapërcimet e pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit.

ANEKSI XVII.

Vendndodhja dhe numri minimal i pikave të marrjes së mostrave për matjen e përqëndrimeve në ajrin e mjedisit dhe normat e depozitimit

(Referuar në paragrafin 13, 14.5, 15.2.b të këtij Vendimi)

I. Përcaktimi i vendndodhjes në shkallë makro

1. Vendndodhjet për marrjen e mostrave përzgjidhen në mënyrë të tillë që:
 - a) të sigurojnë të dhëna për territoret brenda zonave dhe aglomeratëve ku popullsia ka gjasa të ekspozohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë ndaj përqëndrimeve më të larta të mesatarizuara përgjatë një viti kalendarik;
 - b) të sigurojnë të dhëna për nivelet në vendndodhje të tjera në zona dhe aglomeratë që janë përfaqësuese të ekspozimit të popullsisë në përgjithësi;
 - c) të sigurojnë të dhëna për normat e depozitimit që përfaqësojnë ekspozimin jo të drejtpërdrejtë të popullsisë nëpërmjet zinxhirit ushqimor.
2. Pikat për marrjen e mostrave në përgjithësi vendosen në vende të tilla që të shmanget matja e mikro-mjediseve shumë të vogla direct pranë tyre. Si udhëzim, një pikë për marrjen e mostrave është përfaqësuese e cilësisë së ajrit në zonat përreth prej jo më pak se 200 m² në territoret e orientuara nga trafiku, të paktën 250 m x 250 m në zonat industriale, kur është e mundur, dhe disa kilometra katrorë në vendndodhjet me karakter urban.
3. Kur objektivi është vlerësimi i niveleve në sfond vendndodhja e marrjes së mostrave nuk duhet të ndikohen nga zonat, aglomeratët apo zonat industriale në afërsi të tij, që do të thotë territore më afër se disa kilometra.
4. Kur vlerësohen kontributet nga burimet industrial, të paktën një pikë për marrjen e mostrave nga burimi instalohet në drejtim të erës në zonën e banimit më të afërt. Kur nuk dihet përqëndrimi në sfond, duhet shtuar një pikë për marrjen e mostrave në drejtimin kryesor të erës. Në veçanti, kur vlerat e synuara të përcaktuara në Aneksin XV të këtij vendimi tejkalohen, pikat për marrjen e mostrave duhet të vendosen në vendndodhje ku mund të monitorohet zbatimi i TMD-ve.
5. Gjithashtu, kur është e mundur, pikat për marrjen e mostrave, duhet të jenë përfaqësuese të vendndodhjeve të ngjashme jo direkt pranë tyre. Kur është e përshtatshme, ato duhet të integrohen me pikat për marrjen e mostrave për PM₁₀.

II. Përcaktimi i vendndodhjeve në shkallë mikro

1. Udhëzimet e mëposhtme ndiqen për sa kohë janë praktikisht të mundëshme:
 - a) hapësira rreth grykës së sondës për marrjen e mostrave duhet të jetë e pakufizuar, pa pengesa që ndikojnë futjen e ajrit në afërsi të marrësit të mostrës (normalisht disa metra larg ndërtesave, ballkoneve, pemëve dhe pengesave të tjera dhe të paktën 0,5 m larg nga

ndërtesa më e afërt në rastin e pikave të marrjes së mostrave që përfaqësojnë cilësinë e ajrit në vijën e ndërtesës);

- b) në përgjithësi, pika e marrjes së mostrave duhet të jetë midis 1,5 m (niveli i frymëmarrjes) dhe 4 m mbi tokë. Në disa rrethana mund të jenë të nevojshme pozicione më të larta (deri në 8 m). Një pozicion akoma më i lartë se kaq mund të jetë gjithashtu i përshtatshëm në qoftë se stacioni është përfaqësues i një zone të madhe;
- c) sonda hyrëse nuk duhet pozicionuar në afërsi të drejtëpërdrejtë të burimeve me qëllim që të shmanget futja direkte e shkarkimeve të papërziera me ajrin e mjedisit;
- d) me qëllim që të shmanget futja direkte e shkarkimeve që nuk janë përzier me ajrin e mjedisit, sonda hyrëse nuk vendoset ngjitur me burimet;
- e) pikat e marrjes së mostrave të orientuara nga trafiku duhet të jenë të paktën 25 metra nga kryqëzimet e mëdha dhe të paktën 4 m nga qendra e korsisë më të afërt të trafikut; gryka e hyres duhet të pozicionohet në mënyrë të tillë që mostra e marrë të jetë përfaqësuese e cilësisë së ajrit pranë rreshtit të ndërtesave;
- f) për matjen e depozitimeve në vendndodhjet me karakter rural, për aq sa është praktikisht e mundur, dhe kur nuk përcaktohen në Anekse duhet të zbatohen udhëzimet dhe kriteret e EMEP.

3. Gjithashtu, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- a) burimet interferuese;
- b) sigurimi;
- c) aksesi;
- d) aksesi në rrjetin e energjisë elektrike dhe të telefonisë;
- e) vizibiliteti i territorit në lidhje me zonat përreth tij;
- f) siguria e publikut dhe operatorëve;
- g) preferenca për pikave integrale për marrjen e mostrave për ndotës të ndryshëm;
- h) nevoja për planifikim.

III. Dokumentacioni dhe rishikimi i vendndodhjes së përzgjedhur

1. Në fazën e klasifikimit procedurat për përzgjedhjen e vendndodhjes duhet të jenë plotësisht të dokumentuara nga mjete të tilla si fotografitë e zonave përreth dhe një hartë e detajuar. Vendndodhjet duhet të rishikohen në intervale të rregullta me dokumentacion të përsëritur për të siguruar që kriteret e përzgjedhjes mbeten të vlefshme gjatë gjithë kohës.

IV. Kriteret për përcaktimin e numrave të pikave për marrjen e mostrave për matjen fikse të përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo(a)pirenit në ajrin e mjedisit

1. Numri minimal i pikave për marrjen e mostrave për matje fikse për të vlerësuar respektimin e vlerave të synuara për mbrojtjen e shëndetit publik në zona dhe aglomeratë ku matja fikse është burimi i vetëm i informacionit.

(a) Burimet e përhapjes

Popullsia e aglomeratit ose zonës (mijëra)	Në qoftë se përqëndrimet maksimale kapërcejnë pragun e sipërm të vlerësimit (1)		Në qoftë se përqëndrimet maksimale janë midis pragjeve të sipërme dhe të poshtme të vlerësimit	
	As, Cd, Ni	B(a)P	As, Cd, Ni	B(a)P
0-749	1	1	1	1
750-1 999	2	2	1	1

2 000–3 749	2	3	1	1
3 750–4 749	3	4	2	2
4 750–5 999	4	5	2	2
≥ 6 000	5	5	2	2
(1) Të përfshihet të paktën një stacion në mjedis urban dhe për benzo(a)pirenin edhe një stacion i orientuar nga trafiku me kusht që kjo të mos e rrisë numrin e pikave të marrjes së mostrave.				

(b) Burimet e identifikueshme

1. Për vlerësimin e ndotjes në afërsi të burimeve identifikueshme, numri i pikave për marrjen e mostrave për matje fikse duhet të përcaktohet duke marrë parasysh densitetin e shkarkimeve, modelet e mundshme të përhapjes së ndotjes në ajrin e mjedisit dhe ekspozimin potencial të popullsisë.
2. Pikat për marrjen e mostrave duhet të jenë në vendndodhje të tilla ku mund të monitorohet zbatimi i TMD-ve.

ANEKSI XVIII

Objektivat për cilësinë e të dhënave dhe kërkesat për modelet e cilësisë së ajrit

(Referuar në paragrafin 11.2, 12 të këtij Vendimi)

I. Objektivat për cilësinë e të dhënave

Objektivat e mëposhtme për cilësinë e të dhënave duhen përdorur si udhëzues për sigurimin e cilësisë.

	Benzo(a)pireni	Arsenik, kadmium dhe nikel	Hidrokarburet aromatike policiklike përveç benzo(a)pirenit, mërkurit të gaztë total	Depozitimi total
— Pasiguria				
Matjet fikse dhe treguese	50%	40%	50%	70%
Modelimi	60%	60%	60%	60%
— Sigurimi minimal i të dhënave	90%	90%	90%	90%
— Mbulimi minimal i kohës:				
Matjet fikse	33%	50%		
Matjet treguese(*)	14%	14%	14%	33%

(*)Matjet treguese janë matje që kryhen me rregullsi të reduktuar por që plotësojnë objektivat e tjera për cilësinë e të dhënave.

1. Pasiguria (e shprehur me besueshmëri 95 %) e metodave të përdorura për vlerësimin e përqendrimeve të ajrit të mjedisit do të vlerësohet në përputhje me parimet e Udhëzuesit CEN për shprehjen e pasigurisë në matje (ENV 13005-1999), metodologjia e [S SH ISO 5725-1:2008](#) pjesët 2,3,4,5,6 dhe udhëzuesi i dhënë në Raportin CEN, ‘Cilësia e ajrit — Përqasje për vlerësimin e pasigurisë për metodat referencë të matjeve të ajrit të mjedisit (CR 14377:2002E). Përqindjet për pasigurinë jepen për matje individuale, që mesatarizohen përgjatë kohërave tipike të marrjes së mostrave, për intervalin e besueshmërisë prej 95 %. Pasiguria e matjeve duhet konsideruar e aplikueshme rrotull vlerës së duhur të synuar. Me qëllim që të shmanget shtrembërimi i rezultateve matjet fikse dhe treguese duhet të shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme përgjatë vitit.
2. Kërkesat për sigurimin minimal të të dhënave dhe mbulimin kohor nuk përfshijnë humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt apo mirëmbajtjes normale të instrumentave. Për matjen e benzo(a)pirenit dhe hidrokarbureve të tjera aromatike policiklike kërkohet marrja e mostrave njëzet e katër orë. Me kujdes, mostrat individuale të marra gjatë një periudhe deri një muaj mund të kombinohen dhe analizohen si një mostër e përbërë, me kusht që metoda të sigurojë që mostrat të jenë të qëndrueshme për atë periudhë. Tre përbërjet me prejardhje të njëjtë benzo(b)fluoranteni, benzo(j)fluoranteni, benzo(k)fluoranteni mund të jetë e vështirë të ndahen analitikisht. Në raste të tilla mund të raportohet shuma e tyre. Marrja e mostrave njëzet e katër orë është gjithashtu e këshillueshme për matjen e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit dhe and nikelit. Marrja e mostrave duhet të shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme gjatë ditëve të javës dhe gjatë vitit. Për matjen e normave mujore ose javore të depozitimit, rekomandohen mostrat e marra gjatë gjithë vitit.
3. AKM mund të përdorë marrjen e mostrave të njoma në vend të atyre voluminozë nëse mund të demonstron që ndryshimi midis tyre është brenda 10 %. Normat e depozitimit në përgjithësi duhet të jepen si $\mu\text{g}/\text{m}^2$ në ditë.

4. AKM mund të zbatohet një mbulim kohor minimal më të ulët se ai i treguar në tabelë, por jo më i ulët se sa 14 % për matje fikse dhe 6 % për matjet treguese, me kusht që të mund të demonstronhet që për mesataren vjetore të arrihet pasiguria e rritur prej 95 %, llogaritur nga objektivat për cilësinë e të dhënave në tabelë sipas ISO 11222:2002 — ‘Përcaktimi i pasigurisë së mesatares së kohës për matjet e cilësisë së ajrit’.

II. Kërkesat për modelet e cilësisë së ajrit

1. Kur për vlerësimin e cilësisë së ajrit përdoren modelet, hartohen referenca për përshkrimet e modelit dhe informacion për pasigurinë. Pasiguria për modelimin përkufizohet si shmangia maksimale e niveleve të përqendrimit të matur dhe të llogaritur, përgjatë një viti të plotë, pa marrë parasysh kohën kur ndodhin ngjarjet.

III. Kërkesat për teknikat e vlerësimit të objektivit

1. Kur përdoren teknikat e vlerësimit të objektivit, pasiguria nuk duhet të kapërcejë 100 %.

IV. Standardizimi

1. Për analizën e substancave në fraksionin e PM_{10} vëllimi i marrjes së mostrave i referohet kushteve të mjedisit.

ANEKSI XIX

Metodat referencë për vlerësimin e përqendrimeve në ajrin e mjedisit dhe normat e depozitimit

(Referuar në paragrafin 16 të këtij Vendimi)

I. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe analizën e arsenikut, kadmiumit dhe nikelit në ajrin e mjedisit

1. Metoda referencë për matjen e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit dhe nikelit në ajrin e mjedisit aktualisht është duke u standardizuar nga CEN dhe do të bazohet në marrjen manuale të mostrave të PM₁₀ njëlloj si në S SH EN 12341:2005, pasuar nga tretja e mostrave dhe analiza me Spektrometër me Absorbim Atomik apo Spektrometria e Masës ICP. Në mungesë të metodës së standardeve CEN, AKM përdor metodat e standardeve kombëtare ose metodat e standardeve ISO.
2. AKM mund të përdorë gjithashtu çdo lloj metode tjetër për të cilën mund të demonstrojë se jep rezultate të barasvlefshme me metodën e mësipërme.

II. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe analizën e hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e mjedisit

1. Metoda referencë për matjen e përqendrimeve të benzo(a)pirenit në ajrin e mjedisit aktualisht është duke u standardizuar nga CEN dhe do të bazohet në marrjen manuale të mostrave të PM₁₀ njëlloj si në S SH EN 12341:2005. Në mungesë të një metode të standardeve CEN për benzo(a)pirenin apo hidrokarbure të tjera përkatëse aromatike policiklike, AKM përdor metodat e standardeve kombëtare ose metodat ISO siç është standardi ISO 12884.
2. AKM mund të përdorë gjithashtu çdo lloj metode tjetër që mund të tregohet se jep rezultate të barasvlefshme me metodën e mësipërme.

III. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe analizën e mërkurit në ajrin e mjedisit

1. Metoda referencë për matjen e përqendrimeve të mërkurit të gaztë total në ajrin e mjedisit do të jetë një metodë e automatizuar bazuar në Spektrometrinë e Absorbimit Atomik ose Spektrometrinë e Fluoreshencës Atomike. Në mungesë të një metode të standardeve CEN, AKM përdor metodat e standardeve kombëtare ose metodat e standardeve ISO.
2. AKM mund të përdorë gjithashtu çdo lloj metode tjetër për të cilën mund të tregohet se jep rezultate të barasvlefshme me metodën e mësipërme.

IV. Metoda referencë për marrjen e mostrave dhe analizën e depozitimit të arsenikut, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike

Metoda referencë për marrjen e mostrave të arsenikut, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike të depozituara duhet bazuar në ekspozimin e instrumentave matës të depozitës cilindrike me përmasa të standardizuara. Në mungesë të një metode të standardizuar CEN, AKM mund të përdorë metoda të standardeve kombëtare.

V. Teknikat referencë të modelimit për cilësinë e ajrit

1. Teknikat referencë të modelimit për cilësinë e ajrit nuk janë specifikuar ende.

ANEKSI XX
(Referuar në paragrafin 27.2, 28.2 të këtij vendimi)

Informacion i kërkuar në kapitullin VIII lidhur me shtyrjen e disa afateve për arritjen e vlerave kufi dhe përjashtimet nga zbatimi i vlerave kufi

1. Informacion në lidhje me statusin e zbatimit të legjislacionit të mëposhtëm:
 - a) mbi masat që duhet të merren kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike;
(Direktiva e Këshillit 70/220/EEC e 20 Mars 1970 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare mbi masat që duhet të merren kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike (Fl L 76, 6.4.1970, f.1. Direktiva e ndryshuar nga direktiva 2006/96/EC (Fl L 363, 20.12.2006, f. 81).
 - b) mbi masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezulton nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga терминаlet në pikat e shitjes;
Direktiva 94/63/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Dhjetorit 1994 për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezulton nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga терминаlet në pikat e shitjes (Fl L 365, 31.12.1994, f. 24. Direktiva e ndryshuar nga Rregullorja (EC) No 1882/2003 (Fl L 284, 31.10.2003, f. 1).
 - c) për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes;
(Direktiva 2008/1/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Janarit 2008 në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (Fl. L 24, 29.1.2008, f. 8.)
 - d) mbi masat që duhet të merren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore;
Direktiva 97/68/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 Dhjetor 1997 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me masat që duhet të merren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore. (Fl L 59, 27.2.1998, f. 1. Direktiva e amenduar nga Direktiva 2006/105/EC).
 - e) mbi masat në lidhje me cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe dizel;
Direktiva 98/70/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 Tetorit 1998 në lidhje me cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe dizel (Fl. L 350, 28.12.1998, f. 58. Direktiva e amenduar nga Rregullorja (EC) Nr 1882/2003).
 - f) mbi masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime;
Direktiva e Këshillit 1999/13/EC e 11 Mars 1999 për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime;(Fl L 85, 29.3.1999, f.1. Direktiva e amenduar nga Direktiva 2004/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Fl L 143,30.4.2004, f. 87).
 - g) Në lidhje me pakësimin e përmbajtjes së squfurit në disa lëndë djegëse të lëngshme;
Direktiva e Këshillit 1999/32/EC e 26 Prill 1999 lidhje me pakësimin e përmbajtjes së squfurit në disa lëndë djegëse të lëngshme (Fl L 121, 11.5.1999, f. 13. Direktiva e

amenduar nga Direktiva 2005/33/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshilli (Fl L 191,22.7.2005, f. 59).

- h) mbi incinerimin e mbetjeve;
Direktiva 2000/76/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 4 Dhjetorit 2000 mbi incinerimin e mbetjeve (Fl L 332, 28.12.2000, f. 91.)
- i) mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiante të mëdha djegie;
Direktiva 2001/80/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Tetorit 2001 mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiante të mëdha djegie;
- j) mbi tavanet kombëtar të shkarkimit për disa ndotës atmosferik;
Direktiva 2001/81/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Tetor 2001 mbi tavanet kombëtar të shkarkimit për disa ndotës atmosferike.
- k) mbi masat për kufizimin e përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i përbërësve organikë në disa bojra, llaqe dhe produkte për lustrimin e automjeteve;
Direktiva 2004/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 Prill 2004 mbi masat për kufizimin e përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i përbërësve organikë në disa bojra, llaqe dhe produkte për lustrimin e automjeteve. (Fl L 143, 30.4.2004, f.87.).
- l) mbi përmbajtjen e squfurit në lëndë djegëse që përdoren në anije;
Direktiva 2005/33/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 Korrikut 2005 që amendon Direktiven 1999/32/EC në lidhje me përmbajtjen e squfurit në lëndë djegëse që përdoren në anije (Fl L 191, 22.7.2005, f. 59.).
- m) mbi masat që duhen marrë kundër shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive të që djegin gaz natyral apo të lëngshëm që përdoren në automjete;
(Direktiva 2005/55/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 28 Shtatorit 2005 mbi përfaqsimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me masat që duhen marrë kundër shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive të që djegin gaz natyral apo të lëngshëm që përdoren në automjete. (Fl L 275, 20.10.2005, f.1. Direktiva e amenduar nga Rregullorja (EC) Nr 715/2007 (Fl L 171, 29.6.2007, f.1).
- n) për efikasitetin në përdorimin përfundimtar të energjisë dhe shërbimet e energjisë;
Direktiva 2006/32/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Prill 2006 për efikasitetin në përdorimin përfundimtar të energjisë dhe shërbimet e energjisë. (Fl. L 114, 27.4.2006, f. 64).

2. Informacion për të gjitha masat e konsideruara për pakësimin e ndotjes së ajrit në nivel lokal, rajonal apo kombëtar për arritjen e objektivave për cilësinë e ajrit, përfshirë:

- a. pakësimin e shkarkimeve nga burimet e palëvizshme duke siguruar që burimet ndotëse të palëvizshme të djegies (përfshirë ato që përdorin biomasën) si të vogla dhe të mesme janë përshtatur me paisje për kontrollin e shkarkimeve ose janë zëvendësuar;
- b. pakësimin e shkarkimeve nga makinat nëpërmjet vendosjes së paisjeve për kontrollin e shkarkimeve. Për të përshpejtuar adoptimin/përshtatjen e tyre duhet të merret në konsideratë përdorimi i stimuljeve ekonomike;
- c. prokurimi nga autoritetet publike, në përputhje me manualin për prokurimet publike mjedisore, të mjeteve të transportit rrugor, të karburanteve dhe paisjeve me djegie për të pakësuar shkarkimet, përfshirë blerjen e:

- (i) makinave të reja, përfshirë makinat më shkarkime të ulëta,
 - (ii) shërbimet e transportit të makinave më të pastra,
 - (iii) burimet e palëvizshme të djegies me shkarkime të ulëta,
 - (iv) karburantet me shkarkime të ulëta për burimet e palëvizshme dhe të lëvizshme,
- d. kufizimin e shkarkimeve nga transporti nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të trafikut (përfshirë përcaktimin e një çmimi për pikun e trafikut, tarifat e diferencuara të parkimit apo stimuj të tjerë ekonomikë; krijimin e zonave me shkarkime të ulëta);
 - e. për nxitjen e kalimit drejt mënyrave më pak ndotëse të transportit;
 - f. duke siguruar që si burimet e palëvizshme (në masë të vogël, të mesme dhe të madhe) dhe burimet e lëvizshme të përdorin lëndet djegëse më pak ndotëse;
 - g. masat për pakësimin e ndotjes së ajrit përmes sistemit të lejeve të mjedisit, planeve të shkarkimeve kombëtare, dhe përmes përdorimit të instrumentave ekonomikë siç janë taksat, tarifat apo tregtia e shkarkimeve.
 - h. sipas rastit, masat për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve apo grupeve të tjera të ndjeshme.